Sektori i adresave – gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, në sektorin e adresave është zhvilluar projekti i Përditësimit të Sistemit të Adresave, i mbikëqyrur nga Agjencioni Kadastral i Kosovës dhe mbështetur nga Banka Botërore. Ky projekt ka filluar në gjysmën e dytë të muajit Janar dhe do të vazhdoj deri në muajin Shtator, gjatë kësaj periudhë janë kontrolluar në terren të gjitha rrugët e qytetit dhe fshatrave të Komunës së Deçanit, gjithsej mbi 600 rrugë, pjesa e terrenit është përfunduar 100%, ndërsa këto të dhëna të marra nga terreni janë futur në ARIS (sistemi elektronik shtetëror për sistemim të adresave), në masë rreth 80%, dhe gjithçka pritët të përfundoj sipas afateve të paracaktuar nga AKK.

Gjatë këtij projekti, procesi i punës ka qenë printimi i hartave për rrugët para se të dilet në terren, më pas gjatë punës së terrenit janë kontrolluar se a janë të gjithë numrat e vendosur në terren, janë marrë shënime për numrat që mungojnë, hyrjet e reja (shtëpitë ose objektet e reja të ndërtuara), si dhe gjendja e tabelave me emrat e rrugëve, të gjitha këto të dhëna janë futur në sistemin elektronik të adresave ARIS.

Përveç kësaj, janë kontrolluar në terren të gjitha objektet banesore në qytet (të vjetrat dhe të reja) për krijimin e databazës së numërtimit të brendshëm.

Gjithashtu janë kontrolluar edhe vendimet e vjetra për emërtim dhe ri-emërtim të rrugëve, ndërsa vendime të reja të tilla nuk ka pasur.

Më poshtë është e bashkangjitur tabela me të gjitha të dhënat e marra gjatë kësaj periudhe përgjatë implementimit të projektit të Përditësimit të të dhënave të Sistemit të Adresave.

Në vazhdim janë duke u përditësuar të dhënat për fshatrat Strelc i Epërm, Strelc i Ulët dhe Isniq.

Tabela për të dhënat nga sistemi i adresave:

Vendbanimi	Numri i hartave të printuara	Numri i të dhënave të marra nga terreni	Numri i të dhënave të shtuara në ARIS
Baballoq	44	199	199
Beleg	51	104	104
Carrabreg i Epërm	45	133	133
Carrabreg i Ulët	47	186	186
Dashinoc	17	38	38
Deçan	194	473	473
Dranoc	30	177	177
Dubovik	46	143	143
Dubravë	22	35	35
Glllogjan	38	156	156
Gramaçel	41	131	131
Hulaj	15	17	17
Irzniq	56	177	177
Isniq	185	492	250
Kodralli	49	141	141
Lëbushë	47	126	126
Lloqan	13	46	46
Llukë e Epërme	43	135	135

Llukë e Ulët	25	50	50
Lumbardh	32	77	77
Maznik	24	51	51
Papiq	17	44	44
Pobërgjë	34	126	126
Pozharë	16	37	37
Prapaqan	39	98	98
Prekolluk	15	25	25
Prilep	87	193	193
Rastavicë	50	136	136
Ratish i Epërm	23	43	43
Ratish i Ulët	27	39	39
Shaptej	30	44	44
Sllup	21	37	37
Strellc i Epërm	79	350	-
Strellc i Ulët	86	517	-
Voksh	35	85	85
Vranoc i Vogël	7	15	15
TOTAL	1630	4876	3767

➤ **Drejtoria për Buxhet dhe Financa**

Raporti i punës për gjashtë mujorin e parë të vitit 2023 (periudha Janar - Qershor 2023) i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa është në harmoni të plotë me planet e punës së Qeverisë Komunale, duke pasur parasysh respektimin e plotë të Ligjeve dhe rregulloreve që e rregullojnë punën mjaft delikate të kësaj drejtorie.

Qëllimi i këtij Raporti është që të raportohet për mënyrën e ekzekutimit të buxhetit komunal gjatë periudhës **Janar – Qershor 2023**.

Në këtë Raport gjithashtu do të paraqitet mënyra e realizimit të buxhetit komunal sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve si dhe programeve buxhetore komunale.

Të dhënat e Raportit, për shpenzimet operative, investimeve kapitale si dhe të dhënat mbi numrin e punëtorëve dhe shumës për Paga dhe mëditje janë të harmonizuara me Departamentin e Thesarit - MFPT-së.

Ne, gjatë përgatitjes së këtij raporti me përkushtim të madh, saktësi dhe në detaje e kemi paraqitur realizimin e buxhetit komunal për këtë periudhë raportuese.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa funksionon në dy sektorë:

1. Sektori i Buxhetit dhe financave ku është e inkuadruar edhe zyra e te hyrave dhe
2. Sektori i tatimit në pronë.

1. Të Hyrat Vetanake

1.1. Regjistrimin e të hyrave financiare, alokimin e tyre dhe barazim me Thesar

Raporti i përgatitur, mbulon vitin fiskal 2023, dhe paraqet informatën e përcaktuar që kanë të bëjnë me realizimin dhe regjistrimin e të hyrave financiare. Më poshtë janë të paraqitura realizimet e të hyrave vetanake nëpër muaj si dhe tabelat e veçanta të realizimit të gjobave nga trafiku dhe gjobat nga gjykata për tremujorin e parë (TM1 – Janar, Shkurt, Mars), TM2 nuk është i paraqitur pasi që nuk është dërguara ende raporti i TM2 nga thesari.

Raporti i realizimit të të hyrave financiare për periudhën Janar - Qershor	
Te hyrat vetanake në periudha mujore dhe në total për periudhën 6 mujore	
Janar	82,231.08
Shkurt	51,055.20
Mars	69,033.18
Prill	95,789.8
Maj	140,332.27
Qershor	45,834.91
Totali	484,276.44

Raporti i realizimit të të hyrave financiare nga Gjobat ne trafik nga Policia dhe Gjobat nga gjykatat për periudhën Janar - Mars		
Te hyrat vetanake në periudha mujore dhe në total për periudhën 3 mujore TM1		
	Gjobat nga Trafiku	Gjobat nga Gjykata
Janar		11,111
Shkurt	2.000	8,930

Mars	1070	9,485
Totali	3,070	29,526
Totali i te hyrave nga Gjobat në Trafik + Gjobat nga gjykata		32,596 Euro

Të hyrat vetanake: 484,276.44€

Te hyrat nga Gjobat në trafik dhe Gjukata : 32,596€

Totali : 516,872.44 Euro

Realizimi i të hyrave financiare krahasuar me vitin paraprak (Janar - Qershor 2022 dhe Janar – Qershor 2023).




Fig.1. Krahasimi i të hyrave vetanake të vitit 2023 për Periudhën Janar - Qershor me te hyrat vetanake të vitit 2022 duke përfshirë edhe Gjobat në trafik dhe të policisë.

Në shifrën totale për te hyrat e 2023 mungon TM2 i gjobave pasi që nuk është dërguar ende nga thesari.

2. Zotimi i Mjeteve

2.1. Zotimi I Mjeteve për periudhën Janar -Qershor2023

Regjistrimi i të gjitha pagesave në SIMFK nga të gjitha kategoritë buxhetore, mallra shërbime, kapitale subvencione dhe komunal në kodet ekonomike përkatëse, siç është e paraparë me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

- Është bërë zotimi i mjeteve të të gjitha kategorive ekonomike, Mallra dhe Shërbime Kapitale, Subvencione dhe Komunal, totali i të gjitha zotimeve të këtyre kategorive është në vlerën prej **4,674,501.07**
- Mallra – **740,392.00** kurse nga të hyrat vetanake **131,788.07**- totali i Mallrave **872,180.07**
- Kapitale - Grandi Qeveritar **3,035,000.00** nga të hyrat vetanake **653,321.00**- totali i kapitaleve **3,688,321.00**
- Subvencione- Grand Qeveritar **114,000.00** kurse nga të hyrat ishin **30,000.00** - totali i subvencioneve **144,000.00**
- Komunal - **46,400.00**

3. Buxheti dhe Shpenzimet

Nga zyra e Buxhetit dhe Shpenzimeve për periudhën Janar – Qershor 2023, janë regjistruar (procesuar) të gjitha shpenzimet (pagesat) e buxhetit komunal, gjithsej në numër **1712** pagesa nga të gjitha programet e Administratës Komunale, Arsimit dhe Shëndetësi, si dhe njëkohësisht të njëjtat i kemi azhurnuar (regjistruar) në raportin Excel të kontabilitetit.

Nga totali i pagesave **1712**, prej tyre **126** janë nga kategoria e pagave dhe mëditje, **1009** nga kategoria - mallra dhe shërbime, **391** nga kategoria-shërbime komunale, **146** nga kategoria e subvencioneve si dhe **40** nga kategoria e investimeve kapitale.

3.1.Tabela 1

NR.	PËRSHKRIMI	NUMRI I PAGESAVE	TOTALI I PAGESAVE NË EURO
1	PAGA DHE MEDITJE	126	3,689,984.31
2	MALLRA DHE SHËRBIME	1009	948,852.50
3	SHËRBIME KOMUNALE	391	83,842.15
4	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	146	89,892.00
5	INVESTIME KAPITALE	40	2,057,805.17
	TOTALI	1712	6,870,376.13

3.2. Tabela 2. - Buxheti i Alokuar dhe Shpenzuar për Periudhën Janar-Qershor 2023 Sipas Fondeve Burimore dhe Kategorive Ekonomike

PERSHKRIMI	ALOKIMI	SHPENZIMI	D=C-B
------------	---------	-----------	-------

631 DEÇAN	12,368,360.59	6,870,376.13	(5,417,452.46)
10 BUXHETI	11,029,381.47	6,603,925.80	(4,425,455.67)
11 PAGA DHE SHTESA	5,808,061.47	3,689,984.31	(2,118,077.16)
13 MALLRA DHE SHËRBIME	1,695,836.00	791,180.83	(904,655.17)
14 KOMUNALI	200,000.00	83,842.15	(116,157.85)
20 SUBVENCIONE	159,000.00	59,992.00	(99,008.00)
30 PASURITË FINANCIARE	3,166,484.00	1,978,926.51	(1,187,557.49)
			-
21 TË HYRAT VETANAKE	1,098,485.00	266,450.33	(832,034.67)
11 PAGA DHE SHTESA	-	-	-
13 MALLRA DHE SHËRBIME	404,164.00	157,671.67	(246,492.33)
14 KOMUNALI	-	-	-

20 SUBVENCIONE	41,000.00	29,900.00	(11,100.00)
30 PASURITË FINANCIARE	653,321.00	78,878.66	(574,442.34)
			-
22 TË HYRAT VETANAKE NGA VITI I KALUAR	183,174.29	-	(183,174.29)
11 PAGA DHE SHTESA	-	-	-
13 MALLRA DHE SHËRBIME	27,552.92	-	(27,552.92)
14 KOMUNALI	-	-	-
20 SUBVENCIONE	8,028.00	-	(8,028.00)
30 PASURITË FINANCIARE	147,593.37	-	(147,593.37)
			-
31 GRANT I DONATORËVE TË BRENDSHËM	16,027.70	-	(16,027.70)
13 MALLRA DHE SHËRBIME	4.00	-	
30 PASURITË FINANCIARE	16,023.70	-	(16,023.70)

			-
32 GRANT I DONATORËVE TË JASHTËM	974.50	-	(974.50)
13 MALLRA DHE SHËRBIME	974.50	-	(974.50)
			-
57 QEVERIA NORVEGJEZE	7.98	-	(7.98)
30 PASURITË FINANCIARE	7.98	-	(7.98)
59 QEVERIA JAPONEZE	40,266.00	-	(40,266.00)
30 PASURITË FINANCIARE	40,266.00	-	(40,266.00)
			-
93 UNIONI EUROPIAN	43.65	-	(43.65)
13 MALLRA DHE SHËRBIME	43.65	-	(43.65)

3.3. Tabela 3. - BUXHETI I ALOKUAR DHE SHPENZUAR PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2023 SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE

KATEGORIA EKONOMIKE	ALOKIMI	SHPENZIMI	BUXHETI I PA SHPENZUAR
11 PAGA DHE SHTESA	5,808,061.47	3,689,984.31	(2,118,077.16)
13 MALLRA DHE SHËRBIME	2,128,575.07	948,852.50	(1,179,718.57)
14 SHËRBIME KOMUNALE	200,000.00	83,842.15	(116,157.85)
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	208,028.00	89,892.00	(118,136.00)
30 PASURITË FINANCIARE	4,023,696.05	2,057,805.17	(1,965,890.88)
TOTALI	12,368,360.59	6,870,376.13	(5,497,980.46)

4. Certifikimi/Aprovimi i kuponëve të shpenzimit

Raporti i përgatitur, mbulon gjashtë mujorin e parë të vitit 2023 dhe paraqet informatën e përcaktuar që kanë të bëjnë me realizimin e certifikimit të gjitha shpenzimeve buxhetore të Komunës së Deçanit, duke siguruar që shpenzimi i parasë publike është bërë në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me Ligjin nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Realizimi i certifikimit të shpenzimeve për periudhën e lartcekur, ka arritur vlerën prej **5,278,796.61€**, duke përfshi certifikimin në Paga dhe Mëditje, shpenzime Kapitale, Mallra dhe Shërbime, shpenzime Komunali, shpenzime nga Subvencione dhe Transfere si dhe shpenzimet e realizuara nga të Hyrat.

Raporti i Certifikimit/Aprovimit të kuponëve të shpenzimit për periudhën Janar – Qershor 2023

Gjithsejtë certifikimi i shpenzimeve për gjashtë mujorin e parë të vitit 2023, ka arritur vlerën prej 5,278,796.61 €

Janar	448,489.41€
Shkurt	1,468,555.99€
Mars	787,817.47€
Prill	802,058.32€
Maj	796,973.71€
Qershor	974,901.71€

5. Pagesat në Arkë

Pagesat në Arkë bëhen nën vlerën 10 euro dhe përfshijnë pagesat e certifikatave të lindjes, certifikata e vendbanimit, certifikata e vdekjes, certifikata e statusit martesor, certifikata e martesës, certifikata e bashkësisë familjare, certifikata e shtetësisë, ekstrakt i lindjes, vërtetim nga arkiva dhe taksa tjera administrative.

Janar 2023

Raport i fletëpagesave të lëshuara	4294 €
Raport i pagesave të anuluar	111 €
Mjetet e dorëzuara në arkën kryesore	4851€
Mjetet e dorëzuara në arkë sipas kodit Ekonomik	XH.SH-4296€ G.K-371€ S.L-184€

Shkurt 2023

Raport i fletëpagesave të lëshuara	4013 €
Raport i pagesave të anuluar	88 €
Mjetet e dorëzuara në arkën kryesore	4493€
Mjetet e dorëzuara në arkë sipas kodit Ekonomik	XH.SH-4003€ G.K-368€ S.L-122€

Mars 2023

Raport i fletëpagesave të lëshuara	4441 €
Raport i pagesave të anuluar	120 €
Mjetet e dorëzuara në arkën kryesore	4925€
Mjetet e dorëzuara në arkë sipas kodit Ekonomik	XH.SH-4427€ G.K-292€ S.L-206€

Prill 2023

Raport i fletëpagesave të lëshuara	3275 €
Raport i pagesave të anuluar	91 €
Mjetet e dorëzuara në arkën kryesore	3933€
Mjetet e dorëzuara në arkë sipas kodit Ekonomik	XH.SH-3265€ G.K-378€ S.L-101€ S.U-189€

Maj 2023

Raport i fletëpagesave të lëshuara	4228 €
Raport i pagesave të anuluar	126 €
Mjetet e dorëzuara në arkën kryesore	4852€
Mjetet e dorëzuara në arkë sipas kodit Ekonomik	XH.SH-841€ R.S-3437€ G.K-342€ S.L-232€

Qershor 2023

Raport i fletëpagesave të lëshuara	3718 €
Raport i pagesave të anuluar	103 €
Mjetet e dorëzuara në arkën kryesore	4056 €

6. Departamenti i Tatimit në Pronë

- Zyra e tatimit në pronë për periudhën Janar – Qershor 2023, ka inkasuar nga tatimi i pronës vlerën prej **314,042.15 €**.
- Kemi bërë shqyrtimin e ankesave. Të shqyrtuara nga komisioni, **28** ankesa për objekte dhe parcela – dhe janë rregulluar në sistem.
- Kemi pranuar kërkesa dhe kemi bërë përmirësim të vazhdueshëm pranë ZTP, gjithsej nr. **120** kërkesadhe **12** kërkesa për parcela, të gjitha të shqyrtuara dhe të rregulluara në sistem PROTAX.
- Në periudhën Janar - Qershor ishin gjithsej **54** regjistrimetë reja, **45** aplikacione dhe **9** verifikime.
- Certifikata (vërtetime) të pagesave nga sistemi për kryerjen e punëve të ndryshme nga qytetarët janë 5,150 vërtetime të ndryshme sipas kërkesave të: zyrës së kadastrës, nevoja personale, lirim shtetësie, pensione, viza, subvencione, leje pune, tender, certifikata për tatimpaguesit dhe procedura tjera të korrigjimeve.

7. Zyra e Pasurive mbi vlerën 1000 euro

Për periudhën 6 mujore në sektorin e pasurive, teknikisht nuk është punuar shumë për arsye se ka munguar qasja në SIMFK duke marrë parasysh trajnimin dhe mbajtjen e provimit për certifikim. Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar pronat komunale si dhe kanë filluar procedurat për vlerësimin monetar të pronave komunale. Gjithashtu, janë kontrolluar regjistrat e asetëve komunale të regjistruara më parë, duhet cekur se janë regjistruar shumë artikuj të pasurisë gabim dhe të klasifikuara keq. Pas evidentimit të atyre artikujve është përgatitur lënda për gjithsecilën për tu përcjellë për thesar për korrigjimin e tyre. Gjithashtu është regjistruar :

- Në retroaktiv AMF në Gramaçel.
- E-kiosku.
- E-senderi.
- Është mbajt takim me Kryetarin e Komunës së Junikut dhe është lidhur një marrëveshje bashkëpunimi për transferin e asetit komunal, gjegjësisht për shkollën e Junikut “Edmond Hoxha” i cili figuronte ende në regjistrat e pronave të Komunës së Deçanit.

- Përditësimi i shkollës fillore “Maxhun Çekaj”, e cila në SIMFK te modulit të pasurisë është e regjistruar dy herë si objekte te ndryshme, njëherë si Gjimnazi “Sami Frashëri” dhe si SHMFU “Avni Rrustemi”, Rrezar dhe përditësimi aktual duhet të jetë SHGMU “Maxhun Çekaj” Irzniq.
- Përditësimi i Shkollës Fillore “Hasan Prishtina” Gllogjan (e regjistruar si e tillë në SIMFK) duke përgatitur lëndën për korrigjim në thesar, si e tillë duhet të jetë SHFMU “Heronjtë e Dukagjinit” Gllogjan.
- Përditësimi i automjeteve zyrtare të regjistruara në SIMFK dhe tani të shitura duke u bazuar ne dokumentacionin e ankandit ju ndërrohet statusi nga **Në Përdorim** në **E shitur**.
- Gjithashtu është bërë evidentimi i shumë aseteve të cilët duhet të korrigjohen dhe të regjistrohen gjithmonë duke pas parasysh afatin e zhvlerësimit (amortizimit) të tyre.

➤ **Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale**

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, veprimtarinë e saj e zhvillon duke u mbështetur në Ligjin për Shëndetësi, Udhëzimit Administrativ, Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statusin e QKMF-së.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023 ka monitoruar me kujdes të gjitha departamentet e saj si: QKMF, QMF, AMF, QPS dhe SHK.

Ka pranuar takime me qytetarë, ka zhvilluar takime edhe me shumë organizata dhe zyra të huaja me të cilat kemi arritur marrëveshje bashkëpunimi dhe përfitimin e donacioneve kryesisht të natyrës medicinale.

Bashkëpunim më të ngushtë kemi pasur me AMBASADEN JAPONEZE, KFORIN ITALIAN, AQH.

DSHMS për periudhën JANAR-QERSHOR ka pranuar 107 lëndë, prej të cilave: 81 – Miratuar, 2 – Refuzuar, 7 – Pezulluar, 2 – Anuluar.

Specifikimi i detyrave dhe përgjegjësi:

Ofrimin e kujdesit shëndetësor parësor në komunë, në pajtim me dispozitat ligjore
Vlerësimin e nevojave lokale për shëndetësi primare,
Vendosjen e objektivave lokale për kujdesin primar shëndetësor,
Vendos dhe mbledh bashkë pagesat brenda kornizave të caktuara nga Ministria e Shëndetësisë,
Mbikëqyrë situatën epidemiologjike në nivel komunal,
Zhvillimin e buxhetit bazuar në nevojat lokale dhe duke respektuar udhëzimet e MSH
Koordinon dhe mbikëqyrë punën e QKMF, QMF dhe ambulancave,
Operimin e qendrave për punë sociale dhe qendrave për mirëqenie sociale

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Aktivitetet JANAR-QERSHOR, të parapara në planë programin e Komunës për Drejtorinë e Shëndetësisë

Monitorimi i mbarëvajtjes së punës së personelit shëndetësor në QKMF dhe Shtëpinë e Komunitetit
Monitorimi i mbarëvajtjes së personelit në QPS
Përpilimi i raporteve të ndryshme në kuadër të Drejtorisë
Shqyrtimi i mjeteve të ankesave përmes rrugëve administrative
Mbarëvajtja e konkursit publik nga DSHMS mbi personelin shëndetësor
Zbatimi i planit të prokurimit

Planifikimi i buxhetit
Takime me palë dhe shqyrtimin e kërkesave

AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Trajnimet me AQH dhe pranimi i donacioneve nga AQH
Pranimi i donacionit nga Ambasada Japoneze
Furnizimi me pajisje mjekësore
Furnizimi me material administrativ QKMF, QPS, SHK
Servisimi dhe mirëmbajtja e aparaturës mjekësore në QKMF
Furnizimi me barna dhe materialshpenzues në QKMF dhe SHK
Kontrollimi, mbikëqyrja e buxhetit dhe miratimi i tyre sipas fondit, kodit dhe kategorive ekonomike
Alokimet
Koordinimi i punëve në bashkëpunim me menaxhmentin e QKMF-së dhe QPS

AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Hartimi i planit të veprimit të KPSH në nivel Komunal
Rinovimi i QPS dhe pajisja me inventar
Mbikëqyrja e vazhdueshme e punës së përditshme të personelit
Mbikëqyrja e vazhdueshme në ofrimin e ndihmave sociale, pjesëtarëve të komunitetit pakicë
Buxheti për gjashtë mujin e parë të vitit 2023 për DSHSM, QKMF, QPS, SHK.
ZHVP në QKMF-Deçan (trajnimi i stafit)
Identifikimi i nevojave sociale dhe familjare
Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë për analizën në QPS
Përcjellja e Punës së Shërbimeve në QPS me qëllim të avancimit të saj

Buxheti për vitin 2023

Pagat e planifikuara për personel	14,253,00
Mallra dhe Shërbime	10,000,00
Komunali	0
Totali i të hyrave nga B.K.K	24,253,00

Granti për Shëndetësi

Pagat e planifikuara për personel	1,021,038,00
Mallra dhe Shërbime	343,000,00
Komunali	46,046,00
Planifikimi për investime kapitale	85,000,00
Totali i të hyrave nga B.K.K	1,495,084,00
Buxheti i planifikuar nga të hyrat vetanake	
Kapitale	20,000,00
Totali i të hyrave	20,000,00
Totali	1,515 084,00

Shërbimet Sociale

Pagat e planifikuara për personel	64,255,69
Mallra Shërbime	20,000,00
Komunali	7,000,00
Totali i të hyrave nga B.K.K	91,255,69

Shërbimet Rezidenciale

Pagat e planifikuara për personel	90,000,00
Mallra Shërbime	75,000,00
Komunali	8,000,00
Investime Kapitale	10,000,00
Totali	183,000,00

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

QKMF në Deçan është Institucion Publik Parësor Shëndetësor, i cili si qëllim kryesor ka promovimin, ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të popullatës përmes sigurimit të shërbimeve shëndetësore të leverdishme, gjithëpërfshirëse dhe të vazhdueshme për banorët e komunës së Deçanit.

Shërbimet shëndetësore janë të bazuara në konceptin e Mjekësisë Familjare, i cili ka synim që të gjithë banorëve t'u ofrojë shërbime shëndetësore gjithëpërfshirëse dhe efikase, të bazuar në të dhëna shkencore, përmes caktimit të mjekut familjar, i cili do të jetë portë hyrëse për të gjithë kërkuarët e shërbimeve shëndetësore dhe njëherësh pikë referuese për specialistët, konsultantët.

Këto shërbime janë të orientuara në:

Promovim shëndetësor, parandalim, diagnostikim, mjekim dhe rehabilitim të sëmundjeve, çrregullimeve dhe lëndimeve;

Kujdes parandalues nëpërmjet programeve të promovimit të shëndetit, vizitave shtëpiake dhe vizitave sistematike të fëmijëve;
Ruajtjedhe përparim të shëndetit publik, përfshirë sero-profilaksen, vaksino-profilaksen, promovimin e mënyrës së shëndetshme të jetës;
Promovim të shëndetit oral dhe kujdes për shëndetin e dhëmbëve;
Shërbime të kujdesit shëndetësor për nëna dhe fëmijë dhe shërbime të planifikimit familjar;
Shërbime 24 orëshe;

Orari në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare

Mjekësia familjare prej orës 7:00 deri 20:00, 7 ditë në javë, si dhe shërbimi urgjent i cili është në kuadër të QKMF-së punon 24 orë
Vizita pranë mjekut familjar nga ora 7:00 deri 20:00, 7 ditë në javë
Shërbimet diagnostike (rentgen dhe laborator) prej 7:00 deri 20:00, 6 ditë në javë
Shërbimet e vaksinimit prej orës 7:00 deri në orën 15:00, 5 ditë në javë
Pediatria nga ora 7:00 deri në orën 13:30, 6 ditë në javë
Kujdesi oral (stomatologjia) prej orës 7:00 deri në orën 20:00, 6 ditë në javë
Shërbimet terapeutike parenterale (infuzionet, injeksionet) jo emergjente të administruara nga mjekët familjar dhe mjekët specialist qoftë një herë apo dy herë në ditë ofrohen nga ora 7:00 deri në orën 21:00
Infuzionet dhe injeksionet pas kësaj ore jepen vetëm ato që i ordinon mjeku i urgjencës tek rastet urgjente
Shërbimi i urgjencës vazhdon të punoi 24 orë, 7 ditë në javë, duke ofruar shërbime urgjente për qytetarët e Komunës së Deçanit

SEKTORËT NË QKMF-Deçan

- Shërbimi Urgjent

- Mjekësia Familjare
- Vaksinimi
- Pediatria
- Gjinekologjia
- Diagnostika
- Stomatologjia
- Farmacia
- Laboratori
- Dermatologjia

Qendrat funksionale:

- QMF- Irzniq, Isniq, Strellc
- AMF- Gramaqel

JANAR 2023

Departamenti	Vizitat
Mjekësi Familjare	5135
Emergjencia	2949
Gjinekologji	247
Vaksinimi	143
Laboratori	643
Radiologjia	175
Pediatria	794
EKG	147
ECHO	251



Dermatologu	98
Shërbimi Paliativ	107

SHKURT 2023

Departamenti	Vizitat
Mjekësi Familjare	4714
Emergjenca	1927
Gjinekologji	112
Vaksinimi	11
Laboratori	755
Radiologjia	318
Pediatra	848
EKG	172
ECHO	111
Dermatologji	209
Shërbimi Paliativ	113

MARS 2023

Departamenti	Vizitat
Mjekësi Familjare	8928
Emergjenca	3402
Gjinekologji	224
Vaksinimi	992

Laboratori	507
Radiologjia	320
Pediatria	877
EKG	249
ECHO	0
Dermatologji	224
Shërbimi Paliativ	111

PRILL 2023

Departamenti	Vizitat
Mjekësi Familjare	3789
Emergjenca	3127
Gjinekologji	169
Vaksinimi	182
Laboratori	302
Radiologjia	225
Pediatria	560
EKG	201
Dermatologji	171
Shërbimi Paliativ	175

MAJ 2023

Departamenti	Vizitat
Mjekësi Familjare	3737



Emergjenca	3057
Gjinekologji	203
Vaksinimi	145
Laboratori	820
Radiologjia	322
Pediatra	647
EKG	255
Dermatologu	196
ECHO	179
Shërbimi Paliativ	144

QERSHOR 2022

Departamenti	Vizitat
Mjekësi Familjare	2714
Emergjenca	2639
Gjinekologji	175
Vaksinimi	132
Laboratori	632
Radiologjia	272
Pediatra	190
EKG	140
Dermatologji	92
Shërbimi paliativ	157



QENDRA PËR PUNË SOCIALE

Shërbimet Sociale dhe Familjare përfshijnë ofrimin e drejtpërdrejtë të përkujdesjes sociale, këshillimit ose në rastet e veçanta, ndihmë materiale për njerëzit në nevojë sociale.

Person në nevojë nënkupton cilindo person që gjendet në territorin e Kosovës, pa marrëparasysh statusin apo vendin e origjinës, i cili ka nevojë për shërbime sociale për shkak:

1. se është fëmijë pa përkujdesje prindërore
2. se është fëmijë me sjellje asociale
3. se është delikuent i mitur
4. të marrëdhënieve të çrregulluara në familje
5. të moshës së shtyrë
6. të sëmundjes trupore ose aftësive të kufizuara fizike
7. të aftësive të kufizuara mendore
8. të sëmundjes mendore
9. të rrezikut nga shfrytëzimi ose abuzimi
10. të dhunës në familje
11. të trafikut të qenieve njerëzore
12. të varësisë nga alkooli ose drogat
13. të emergjencave ose fatkeqësive të shkaktuara nga natyra apo njeriu
14. ose për ndonjë arsye tjetër që i bën ata persona nevojtarë.

Në Komunën e Deçanit në Qendrën për Punë Sociale kryhen këto shërbime:

Llojet e Shërbimeve të kryera ndaj Klientëve JANAR –QERSHOR 2023	
Të miturit në Konflikt me Ligjin- Delikuenca, Anamneza	13
Fëmijët e keqtrajtuar	1



Fëmijët e braktisur,potencial për Adaptim	0
Fëmijët pa përkujdesje prindërore me strehim tek tëafërmit	0
Fëmijët me aftësi të kufizuara	2
Kujdestaria ndaj fëmijëve	3
Kërkesë për adoptim	6
Dhuna në familje	13
Viktimat e trafikimit	0
Kërkesa për këshilla martesore	8
Familje Strehuese	0
Mbrojtja e personave të moshuar-vendosja nështëpinë e pleqve	1
Puna e rrezikshme e të miturve	2
Përdoruesit e substancave Narkotike	2
Përdoruesit e Alkoolit	0
Martesa e të miturve	1
Vizita në terren	35
Përfaqësim në seanca gjyqësore	32
Kontaktime të zhvilluara me familje dhe fëmijë	35
Vërtetime për aplikim të shlyerjes së shtetësisë së Kosovës	46

Vërtetime për Armëmbajtje	190
Certifikatapër aplikim-punësim	21
Konstatime, sugjerime, udhëzime të ndryshme	58
Caktimi i kujdestarit pas marrjes sëzotësisë së veprimit nga Gjykata	3
Përpilimii Raporteve për Shërbimin e SAS-it	13
Anamneza për bashkim familjar	13
Vërtetimpër mbajtje financiare përanëtarët e familjes nga familjare që gjenden jashtë shtetit të Kosovës	8
Autorizime përudhëtimejashtë vendit	0
Raporte për shkurorëzime	0
Vendosja e grave me fëmijë në Shtëpinë e sigurt pas dhunës në familje	1
Vendosja e grave me fëmijë tek tëafërmit pas dhunës ne familje	5
Vizita nëpër shkolla	13
Përfaqësimi në polici	25
Aktvendime të ndryshme	10
Kërkesa	8
Konstatim	2
Njoftime	5
Shënime zyrtare	1
Raporte për FAKP	5
Raporte të ndryshme	15

Pëlqime të ndryshme	12
Gjithsej	610

Raporti i shërbimeve të Asistencës Sociale për gjashtëmuajin e parë të vitit 2023

LLOJET E SHËRBIMEVE	JANAR-QERSHOR
Kërkesa të reja për ndihmë sociale, kategoria I	9
Kërkesa të reja për ndihmë sociale, kategoria II	12
Kërkesa të Aprovuara nga komisioni mjekësor	107
Ri aplikime të kategorisë së I	128
Ri aplikime të kategorisë së II	110
Ndërprerja e Ndihmave Sociale	10
Kërkesat e refuzuara nga komisioni mjekësor	2
Ankesa në DMS	0
Ankesa në Gjykatën Supreme	0
Vërtetime për studente	0
Autorizime	0
Riaktivizime	10
Vazhdimi i kartonëve për ndihmë sociale	238
Vizita në familje	238
Numri i familjeve me asistencë sociale	312
Tereni-verifikimi i kërkesave të reja	21
Shuma financiare	240.58
Vërtetim që nuk është me asistencë sociale	20

Shtëpia e Komunitetit

Roli i Shtëpisë së Komunitetit në Deçan është i veçantë dhe i domosdoshëm për rrethanat ekzistuese meqenëse një numër i caktuar i personave kanë nevojë për një përkujdesje të vazhdueshme nga institucionet.

Aktualisht në Shtëpinë e Komunitetit, janë 8 pacientë dhe gjatë këtyre muajve sipas vlerësimit të komisionit është pranuar dhe njërezident, të cilët kanë përkujdesje të vazhdueshme nga stafi mjekësor.

- Neuropsikiatri
- Psikologu
- Infermieret

Përkujdesje Mjekësore ndaj pacienteve
Pranimi i pacienteve të rinjë
Vizitat Familjare
Mirëmbajtja e Objektivit (gëlqerosje, dhe riparimi i SHK)
Monitorimi i punës së Shtëpisë së Komunitetit
Rekreacioni i Rezidentëve
Shërbimet Laboratorike
Buxheti i mjaftueshëm
Shërbime nga QKMF

➤ Drejtoria për Arsim

Të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë janë realizuar gjatë kësaj periudhe me përkushtim dhe me përgjegjësi të plotë.

Me prezantimin e këtij raporti do të jeni më afër të njohur dhe të informuar sidomos në aspektin zyrtar për punën, organizimin dhe zhvillimin transparent të politikave arsimore në Deçan.

Procesi arsimor gjatë këtij viti ka qenë vazhdimisht i përcjell me kujdes nga Departamenti jonë, ku të gjitha institucionet arsimore janë vizituar disa herë, si nga ana e Drejtorit, ashtu edhe nga zyrtarët e arsimit.

Kemi realizuar mbledhje të rregullta me drejtorë të institucioneve shkollore.

Janë mbajtur takime të rregullta edhe më MASHTI-in, ku çdo detyrë e dhënë nga ana e tyre është realizuar me sukses nga ana jonë.

STRUKTURA ORGANIZATIVE - Këtë sektor e përbëjnë 6 punëtor:

Drejtori

Udhëheqësi i Sektorit për Arsim,

Përgjegjësjë për Buxhet dhe Financa

Zyrtari për Arsimin e Mesëm të Lartë

Zyrtari Ligjor

Zyrtari për Arsimin Fillor

Zyrtari i Lartë Administrativ

Deçani ka një Institucion parashkollor (publiko - privat) dhe një privat, 18 shkolla fillore dhe të mesme të ultë,(4 paralele të ndara fizike), 2 shkolla të mesme të larta, gjithsejtë 24 objekte shkollore publike.

Ku punojnë gjithsejtë 577 punëtor dhe ndjekin mësimin e rregullt 4968 nxënës. 34 punëtor administrativ, 457 mësimdhënës, 86 punëtor teknik.

25 punëtor në nivelin arsimor 0 (Parafillor)

138 punëtor në nivelin arsimor 1 dhe 2

79 punëtor në nivelin arsimor 3

Aktivitetet më të rëndësishme të realizuara :

- Mbledhje të rregullta, dhe takime ditore, javore me drejtorë të institucioneve shkollore janë realizuar në vazhdimësi. Në këto takime është kërkuar angazhim edhe më i madh i mësimdhënësve për ngritjen e cilësisë në arsim, respektim në përpikëri të ligjeve, udhëzimeve dhe rregulloreve në fuqi.
- Vizita të rregullta në shkolla për të parë nga afër ecurinë e procesit mësimor.
- Mbledhje të rregullta me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Është përruruar objekti i ri i shkollës me standarde bashkëkohore i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët “Drita” në fshatin Gramaçel të Deçanit.
- Është përruruar objekti i ri i shkollës me standarde bashkëkohore i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët “Heronjtë e Dukagjinit” në fshatin Gllogjan të Deçanit
- Vlerësimi i performancës së brendshme dhe të jashtme të shkollave nga vlerësimi i brendshëm (DKA) janë vlerësuar drejtor/e të institucioneve publike të arsimit para universitare edhe nga vlerësimi i jashtëm me performancë të shkëlqyer dhe të mirë.
- Pranimi i raporteve të rregullta në baza ditore, javore, mujore, vjetore nga të gjithë drejtorët e shkollave. Interesimi dhe angazhimi i të gjithë akterëve (personelit arsimor, prindërve, nxënësve, stafit mbështetës etj).
- Është realizuar studimi rapid i të gjitha shkollave me qëllim të identifikimit të pikave të dobëta në secilën shkolle në mënyrë që të jenë in putë për hartimin e strategjisë së arsimit në nivel komunal
- Në ngritjen e cilësisë së arsimit në përgjithësi ka ngritje dhe kushte më të mira për nxënës dhe personel.
- Deçani tashmë i prin disa komunave në nivel vendi sa i përket sukseseve në lëndë të ndryshme shkollore, garat komunale dhe ato mbarëkombëtare .
- DKA është vlerësuar nga SIA –MASHTI për zbatueshmërinë e normativit dhe fondit të orëve, ku i prijmë komunave të Kosovës.
- DKA është vlerësuar nga divizioni për ngritje dhe zhvillim profesional të mësimdhënësve nga MASHTI për suksesin e lartë të arritur dhe prijmë para të gjitha komunave të Kosovës.
- Mbikëqyrja në institucionet edukative arsimore, sipas objektivave të paraparë nga ana e zyrtarëve dhe drejtorit të DKA-së, ku zyrtarët kanë mbështetur stafin e shkollave me këshilla profesionale.

- Përgatitjet dhe organizimi e testeve: të arritshmërisë, maturës shtetërore -2023, testi PIRLS, testi TIMMS.
- Janë realizuar planifikimet për fondin e orëve të klasave me kurrikulën e re dhe zbatimi i udhëzuesit për ndarjen e orëve me zgjedhje.
- Sa i përket realizimit të fondit të orëve si dhe procedurave rekrutuese të konkurseve sipas SIA –MASHTI (regjioni i Pejës) DKA Deçan i prin të gjitha komunave në regjionin e Pejës.
- Mbajtja e garave komunale në lëndën: matematikë, fizikë duke bashkëpunuar me organizatat në nivel nacional dhe kombëtare.
- Mbajtja e ligjëratave në shkolla nga Policia e Kosovës, lidhur me parandalimin e dukurive negative të nxënësit dhe të rinjtë (ligjëratat me tema specifike janë mbajtur çdo muaj, me fokus grupe).
- Publikimi i konkurseve dhe regjistrimi i fëmijëve si dhe nxënësve në institucionet arsimore si: institucioni parashkollor dhe në klasat e para.
- Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit, gjatë kësaj periudhe ka pasur takime bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme, ku janë shtjelluar tema të ndryshme që kanë të bëjnë me zhvillimin, mbështetjen dhe avancimin e procesit mësimor dhe reformave në arsim: Ekspert të arsimit nga BE, Fakulteti i Edukimit, përfaqësuesit e GIZ-it, për sa i përket trajnimeve dhe zhvillimit profesional të mësimitdhënësve, Caritasi Zvicëran, KFOR-in etj.
- Futja e të dhënave statistikore për numrin e fëmijëve dhe personelit, në sistemin EMIS-MASHTI.
- Në mënyrë të vazhdueshme bëhet integrimi në institucione arsimore dhe trajtimi i fëmijëve me nevoja të veçanta.
- Në fushën e psikologjisë, me psikologë të shkollave gjatë punës së vazhdueshme profesionale, në vitin 2023 kemi mbajtur trajnime për vetëdijesim të nxënësve lidhur me parandalimin e dukurive negative, në të gjitha shkollat kemi mbajtur në formë relative trajnime me tema të rëndësishme të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e tyre, si;
 1. Bullizmi dhe masat parandaluese,
 2. Pasojat e narkotikeve,
 3. Dhuna në Familje,
 4. Masat e sigurisë ndaj keqpërdorimit të Internetit,
 5. Parandalimi i ngacmimeve Seksuale dhe masat ndëshkimore ligjore,
 6. Respektimi i shumëllojshmërisë së shoqërisë me qëllim të parandalimit të ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm,
 7. Siguria e qarkullimit të këmbësorëve në trafik,
 8. Ruajtja e ambientit dhe e trashëgimisë kulturore.
- Në këtë periudhë kemi pas bashkëpunim me asistent të FAMNV, për të ndihmuar në procesin e mësimin për FAMNV, të asistoj në hartimin e PIA për mësimitdhënës të cilët nuk kanë pasur mundësi të hartojnë këtë plan i cili është mjaft i vështir si punë fillestare për mësuesit të cilët duhet ta kenë si plan të rregullt për këta fëmijë.

- Gjatë kësaj periudhe kemi trajtuar në aspektin psikologjik rastet të cilat kanë pasur nevojë për këtë trajtim; familjet për fëmijët e vet, institucionet arsimore, QPS.
- Në ambientet e Sh.F.M.U "Kuvendi i Verrave të Llukës" është organizuar Punëtori me temën: Diskutim rreth detyrave përgjegjëse dhe vështirësive të Asistentëve për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore, gjatë kryerjes së punës dhe detyrave të tyre. Trajnimi u organizua nga koordinatori i Ekipës Komunale për vlerësim pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta z. Besart Cacaj nga DKA-ja, kurse u realizua nga psikologja Besarta Tahirukaj-Idrizi dhe Florenta Molliqaj, Magjistër e Edukimit Inkluziv. U diskutuan problematika, vështirësitë që asistentët hasin në punën e tyre me fëmijë me nevoja të veçanta po ashtu u shkëmbyen përvoja u dhanë këshilla e sugjerime rreth kësaj pune sa sfiduese dhe e ndjeshme njëkohësisht.
- Për nder të 7 Marsit, ditës së mësuesit, Drejtori i Arsimit, u ndau mirënjohje për mësimdhënësit e komunës së Deçanit.
- Çdo vit me datën 7 Mars në Ditën e Mësuesit, Ministria e Arsimit ndan çmimin “Shaban Jashari” dhe mirënjohje për mësimdhënësit e përkushtuar dhe të dalluar në profesionet e tyre, në mesin e shumë mësimdhënësve të tillë, Drejtoria e Arsimit e ka propozuar Arbëresha Dautaj të cila mirënjohjen në këtë ditë të shënuar.
- Në organizim të DKA-së, u mbajt punëtori më mësimdhënësit e shkollave tona. Punëtorinë me temën "Zbatimi praktik i kurrikulës së re" e udhëhoqi PHD.CAN Pedagogu Hysen Balaj. Gjatë punëtorisë, mësimdhënësit i vizitoj Drejtori i DKA-së z. Besnik Hulaj, ku i inkurajoj mësimdhënësit që informatat e përfituara në punëtori t'i praktikojnë më nxënësit e tyre, gjithashtu i siguroj ata që punëtori të tilla do të organizohen edhe në të ardhmen. Punëtorinë e ndjekën 40 mësimdhënës të të gjitha niveleve.
- Ekipi komunalë për parandalim të braktisjes së shkollës është marr me rastet që kanë pasur tendencë braktisje.
- Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur më datë 30.03.2023, e miratoj: RREGULLOREN PËR NDARJEN EBURSAVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË DEÇANIT. Në Rregullore, përcaktohen procedurat, kushtet, kriteret për ndarjen e bursave, kohëzgjatja e realizimit të bursës, për studentë të studimeve themelore, në Universitet Publike në Republikën e Kosovës dhe Universitetet Publike jashtë Kosovës, formimi i komisionit dhe e drejta e ankesës. Komuna e Deçanit, çdo vite akademik, do të ndan bursa për studentë të Komunës së Deçanit. Fëmijët e dëshmorëve, të cilët janë studentë, më automatizëm do të jenë përfitues të bursës, ndërsa të tjerët do të ju nënshtrohen kriterëve të parapara në rregullore.
- Komisioni Komunal i themeluar nga Drejtori i DKA-së u takuan për Draftin e Rregullores Komunale: Për përzgjedhjen e mësimdhënësit të dalluar në komunën e Deçanit. Rregullorja ka për qëllim motivimin e mësimdhënësve në drejtim të avancimit të punës së tyre në procesin edukativo-arsimor, kryerjen e detyrave me përkushtim dhe shtimin e angazhimit të tyre për arritjen e pritshmërisë dhe përmbushjen e objektivave.

- Shkolla “Drita” në Gramaçel ishte përfituese e projektit “Shkollat Multietnike”, projekt ky me vlerë rreth 15,600 €. Me këto mjete u siguruan mjete të mjaftueshme për kabinetet e shkencave të natyrës, matematikës, historisë dhe gjeografisë! Falënderim i veçantë për organizatën IOM dhe udhëheqësen e këtij projekti A. Çavolli, Komuna sigurojë rreth 30% të mjeteve financiare.
- Drejtoria e Arsimit në Deçan në bashkëpunim me zyrën e kryetarit të komunës ka organizuar festën e Abetares së bashku për të gjitha shkollat e komunës sonë.
- Duke u bazuar në Udhëzimin e ri Administrativ nr.01/2023 Zgjedhja, Themelimi dhe Funksionimi i Këshillit të Prindërve, në shkollat e Komunës së Deçanit ka përfunduar përzgjedhje të re të këshillave të prindërve.
- Sipas këtij udhëzimi të ri administrativ nr.01/ 2023, por dhe Ligjit për Procedurë Administrative Neni 40, Paragrafi 2, sot është bërë zgjedhja e Këshillit të Prindërve të Komunës së Deçanit. Kryetare u zgjodh znj. Albina Lokaj
- Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.09/2023 për regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë, po bëhet vlerësim i fëmijëve. Pas raportit dhe rekomandimeve të marrura nga ky vlerësim drejtoria e shkollës do të merr vendim për regjistrimin e këtyre fëmijëve në klasën e parë.
- Në raportin e Auditorit të jashtëm për vitin kalendarik 2022, nuk kem marrë as një vërejtje ose rekomandim.
- Ndamë mirënjohje për nxënësen e dalluar të gjimnazit “Vëllezërit Frashëri” Alisa Çekaj, me motivacionin për arritje të lartë në matjen e IQ (koeficienti i inteligjencës).
- Për nder të 24 Marsit “Epopesë së Dukagjinit”, nxënësit e komunës sonë shkruan 24 poezi për të rënë për liri.
- DKA ishte në disa shkolla pjesëmarrëse në manifestimin e Ditës së Shkollës.

Çështjet ligjore dhe të personelit për periudhën janar – qershor 2023

- Ndërprerje e marrëdhënies së punës për shkelje të rënda masave disiplinore-----2
- Konkurse ----- 25
- Rishpallje të konkursit ----- 13

Të ndryshme:

- Shpallje të rezultateve të konkurseve
- Vendime të komisioneve intervistuese
- Vendime të lehonisë
- Aktvendime për pensionim
- Aktvendime të ndryshme
- Vendime të ndryshme
- Njoftime të ndryshme (për ushqim,udhëtim, inflacion, gradim,etj)
- Hartimin e pëlqimeve të ndryshme
- Hartimin e kërkesave të ndryshme

Ndryshime në listat e pagave:

- Punëtor të rinjë
- Punëtor të larguar
- Ndryshime në listën e pagave
- Retroaktive
- Transfer bankar
- Ndalesa administrative për drejtoret e shkollave dhe stafin e shkollë.

Donacione

- Donacion kompjuter (PC) nga Universteti "Haxhi Zeka" në Pejë në shkollën “Jusuf Gërvalla” në Prapaqan dhe shkollën “Dëshmorët e Kombit” në Strelc i Ulët. Me këtë rast, u funksionalizua kabineti i TIK-ut dhe janë pajisur me kompjuter: salla e mësimdhënësve, klasat dhe biblioteka.
- Donacion nga Kolegji Maerlant - Holandë, për shkollën "Bajram Curri" në Strelc të Epërm,

Kjo falë z. Berat Hasan Hasanramaj i cili grumbulloi mjete të vlefshme shkollore si: Desktop digjital, Tv, Lp, Kompjuter, Projektor, Mikroskopa, Tabela magnetike, Karrige, Tavolina dhe shumë mjete tjera të konkretizimit.
Ky donacion nuk do ishte realizuar pa ndihmën e pa kursyer të djemve të Shoqatës "Haki Povataj" me seli në Zvicër dhe krytarit të ndëruar z. Ozmon Ukaj, të cilët paguan transportin deri në shkollë.
- Përrurimi i këndit të lojërave në oborrin e Shkollës Fillore “Bajram Curri” në fshatin Strelc i Epërm, projekt ky i realizuar nga Organizata Humanitare “Humanity First” në vlerë prej 10,000 eurove.

RAPORT I SHPENZIMEVE TË BUXHETIT JANAR-QERSHOR 2023, SEKTORI I ARSIMIT

GRANTET QEVERITARE/Fondi
10

SEKTORI I ARSIMIT, KOMUNA DEÇAN

N r.	Programi/Nën programi	Kodi ek.i Nënprogramit	Buxheti i Planifikuar	Aktuali/Shpenzimet (Janar-Qershor)
I.	Administrata e Arsimit	92075		
1.	11 PAGA DHE SHTESA		47 938.59	26 254.13
2.	13 MALLRA DHE SHËRBIME		7 000.00	3 902.25
II.	ARSIMI FILLOR	93420		
1.	11 PAGA DHE SHTESA		2 793 802.36	2 041 018.52
2.	13 MALLRA DHE SHËRBIME		230 509.38	24 533.99
3.	14 SHPENZIME KOMUNALE		21 500.00	12 549.60
	300 / PROJEKTET KAPITALE		36 484.00	0.00
II I.	ARSIMI I MEËM	94620		
1.	11 PAGA DHE SHTESA		752 046.31	412 296.42
2.	13 MALLRA DHE SHËRBIME		37 165.00	15 479.58

3.	14 SHPENZIME KOMUNALE		10 000.00		6 210.00
----	--------------------------	--	-----------	--	----------

- **Investimet kapitale**

Gjatë muajit janar – qershor 2023 në Drejtorin e Arsimit janë realizuar këto projekte kapitale:

- Me investimin e Komunës dhe MASHTI-T kanë përfunduar punimet në shkollën "Dëshmorët e Baballoqit" në Baballoq.

Lyerja e brendshme, dyert, ndriqimi në shkollë dhe inventari i administratës kanë qenë pjesë e projektit.

-Po punohet me intenzitet të shtuar në objektët e reja shkollore, këtyre ditëve në SHFMU "Lan Selimi" në Lumbardh dhe SHFMU “Faik Konica” në Ratish

Po punohet në finalizim të projekteve.

-Po vazhdojnë punimet në ndërtimin e punëtorive dhe sallës së sporteve në IAAP “Tafil Kasumaj” në Deçan.

- Për krijimin e një ambienti sa më të sigurt për nxënësit tonë, kanë filluar punimet në ndërtimin e rrethojave dhe pastrimin e ambientit në shkollën fillore “Ardhmëria” në fshatin Beleg.

Nxënësit fitues në Garën komunale nga Lënda e Fizikës

Në organizim të Shoqatës Kosovare të Fizikës dhe Drejtorisë Komunale të Arsimit në Deçan, me datën 11.02.2023 u mbajtën Garat Komunale të Fizikanëve të Rinj 2023, për nxënësit e klasave të IX, X, XI dhe XII,

Pjesëmarrës në garë ishin rreth 90 nxënës nga të gjitha shkollat e komunës sonë,

Nxënësit fitues e vendeve të para do ta përfaqësojnë komunën tonë në Garat Republikane që do të mbahen me datën me 25 shkurt 2023 (ditë e shtunë) në ora 11.00 në Sh.F. "Abdyl Frashëri" në Prizren.

Rezultatet janë këto:

Klasa e IX-të

Vendi i parë: Arsa Bajraktari nga SHFMU "Lidhja e Prizrenit"

Vendi i dytë: Yll Tolaj nga SHFMU "Sylejman Vokshi"

Vendi i tretë: Olta Haxhaj nga SHFMU "Lidhja e Prizrenit"

Klasa X-të

Vendi i parë: Egzon Idrizaj nga Gjimnazi "Vëllezërit Frashëri"

Vendi i dytë: Korab Berisha nga Gjimnazi "Vëllezërit Frashëri"

Vendi i tretë: (më pikë të barabarta janë)

- Leart Muçaj nga Gjimnazi "Vëllezërit Frashëri"

- Rinor Selmonaj nga IAAP "Tafil Kasumaj"

- Ernisa Shabanhaxhaj nga Gjimnazi "Vëllezërit Frashëri"

Klasa XI-të

Vendi i parë: Ali Gashi nga Gjimnazi "Vëllezërit Frashëri"

Vendi i dytë: Fatjon Dobraj nga Gjimnazi "Vëllezërit Frashëri"

Vendi i tretë: Enis Gjocaj nga IAAP "Tafil Kasumaj"

REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË GARAVE TË XXIV SHTETËRORE NË FIZIKË 2023

- Egzon Idrizaj, nxënës - klasa e X-të në Gjimnazin "Vëllezërit Frashëri" zuri vendin e dytë,

- Arsa Bajraktari, nxënëse - klasa IX-të në SHFMU "Lidhja e Prizrenit" zuri vendin e tretë.

Egzoni dhe Arsa janë kualifikuar të marrin pjesë në Olimpiadën Kosovare të Fizikës 2023.

Egzoni dhe Arsa edhe një hap drejtë Olimpiadës Ndërkombëtare të Fizikës.

Gara sportive

-Garat Komunale në Ping Pong!

Nën organizimin e Shoqatës së Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit në Deçan, në bashkëpunim me Drjtorinë Komunale të Arsimit dhe përkrahur edhe nga Kryetari z.Bashkim Ramosaj, dt.08.02.2023, u mbajtën garat Komunale në Ping Pong për të dy gjinitë.

Ishin 17 ekipe konkurruese pjesëmarrëse, 10 shkolla me ekipe meshkuj dhe 7 shkolla me ekipe femra.

Garat u zhvilluan në Palestrën e Edukatës Fizike në shfmU "Maxhun Çekaj" - Irzniq .

Vendin e parë në kategorinë Meshkujve e zunë nxënësit nga shkolla "Maxhun Çekaj" nën përkujdesjen e profesorit Venon Lushaj,

Vëndin e dytë e zunë nxënësit nga shkolla "Isa Boletini" nën përkujdesjen e profesorit Shyqri Zeqiraj,

Vendin e parë në kategorinë e vajzave e zunë nxënësit e shkollës "Isa Boletini" në Isniq

Vendin e dytë e zonës nxënësit e shkollës "Maxhun Çekaj" Irzniq!

-Me dt.13.02.2023, u mbajtën garat Regjionale në Ping - Pong të organizuara nga Federata e Sportit Shkollor të Republikës së Kosovës.

Në garë ishin ekipet nga Deçani, Peja, Istogu, Klina dhe Juniku.

Shkollat tona e përfaqësuan në mënyrën më të mirë komunën tonë. Ekipi i djemve nga SHFMU "Maxhun Çekaj" nga Irzniqi, e zuri vendin e parë!

Nxënësit e kësaj shkolle ishin nën përkujdesjen e Profesorit të Ed. Fizikë z. Venon Lushaj.

Ekipi i djemve të Gjinnazit "Vëllezërit Frashëri" e zurën vendin e parë!

Gjinnazistët ishin nën përkujdesjen e Profesorit të Edukatës Fizike z. Edmond Gjokaj, të pagatitur nga aktivi i Ed. Fizikë të Gjinnazit "Vëllezërit Frashëri" në Deçan.

-Në nderim të "Epopesë së Dukagjinit", komuna e Deçanit në bashkëpunim me DKA-në, organizuan aktivitetin sportiv, tashmë tradicional, krosin "Rruga e Lirisë" me nxënësit e shkollave fillore.

Po ashtu u hap e ekspozita "Marsi Lirisë", me punime të nxënësve kushtuar Epopesë së Dukagjinit.

Nderimi i dëshmorëve të rënë për liri është simbolika e kësaj gare.

-Djemtë e Gjinnazit "Vëllezërit Frashëri" shpallen Kampion të Republikës së Kosovës në Hendboll dhe vajzat shpallen nënkampione.

Gjinnazi "Vëllezërit Frashëri" e përfaqëson Kosovën në garat ndërkombëtare në Hendboll për të dytin vit radhazi.

Garat komunale në vallëzim

Nën kujdesin e kryetarit të komunës, z. Bashkim Ramosaj, në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit për nder të 15 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës.

U mbajt gara në vallëzim me karakter garues ku morën pjesë 16 shkolla fillore, me valle popullore tradicionale.

U ndan nga dy vende të I-a;

SHFMU - “Lan Selimi” - Lumbardh

SHFMU - “Lidhja Prizrenit” - Deçan.

Dy vende të II-a;

SHFMU - “Dëshmoret e Baballoqit” - Baballoq

SHFMU - “Drita” - Gramaçel.

Dy vende të III-ta;

SHFMU - “Bajram Curri” - Strellc i Epërm

SHFMU - “Maxhun Çekaj” - Irzniq.

Valltarja më e mirë, Orgesa Ramosaj, SHFMU - “Lidhja e Prizrenit” - Deçan.

Valltari më i mirë, Shkelzen Mataj - SHFMU - “Dëshmoret e Baballoqit” - Baballoq.

Koreografia më e mirë, SHFMU - “Rexhep Kadrijaj” - Rastavicë.

Kostumografia më e mirë, K.V - Llukës.

Çmimi i Pavarësisë, SHFMU “Heronjtë e Dukagjinit” - Gllogjan.

Çmimi i DKA, “Dëshmorët e Kombit” - Strellc i Ulët.

Çmimi i DKRS - së, SHFMU - “Dëshmorët e Vokshit” - Pobërgjë.

Çmimi i Publikut, SHFMU - “Ardhmëria” - Beleg.

Çmimi i Diasporës u nda në dy shkolla;

SHFMU - “Sulejmon Vokshi“ - Prejlep

SHFMU - “Jusuf Gërvalla“ - Prapaqan.

Grupi me kompakt “Esat Mekuli“ - Maznik.

Grupi i dalluar, “Lan Selimi“ - Llukë e Ulët.

➤ **Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural**

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës dhe aktiviteteve në Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Komunën e Deçanit që janë planifikuar periudhën Janar – Qershor 2023.

Nr	PERMBAJTJA-Aktivitetet	KOHA	ZBATUES	PJESËMARRJA	MIRATON
1	Realizimi i planit 6 mujor i punës së Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	Janar - Korrik	DBPZHR	DBPZHR	Kryetari
2	Përgatitja e projekteve zhvillimore: Projekti i 44 lopëve qumështore	Janar-Qershor	DBPZHR, Donatori	DBPZHR	Kryetari
3	Takime zyrtare me MBPZHR dhe Ministritë të tjera, OQ dhe OJQ	Tri takime	DBPZHR	DBPZHR, MBPZHR dhe Ministritë të tjera, OQ dhe OJQ	
4	Takime me Donatorin – OJQ-në Mëshqerra dhe Drejtorinë	Shkurt-Mars	DBPZHR - QIKB	DPBZHR, MBPZHR dhe fermerët	Kryetari
5	Shpërndarja e 44 krerë lopë qumështorë	Shkurt - Mars 2023	DBPZHR& OJQ “Mëshqerra” Prishtinë	DPBZHR, MBPZHR dhe blegtorët	
6	Pëlqimi i 14 kërkesave për Shndërrimin e tokave bujqësore ne ato ndërtimore	Janar - Qershor	DBPZHR - Shefi i drejtorisë	DBPZHR dhe MBPZHR	
7	Përgatitja për fushatën e korrje-shirjeve 2023	Korrik – Gusht 2023	DBPZHR - Zyrtari me staf	DPBZHR, MBPZHR, fermerët dhe auto kombajnerët	
8	Përcjellja e kulturave pranverore	Janar - Qershor	DBPZHR - Zyrtari me staf	DPBZHR dhe fermerët	

		3			
11	Grumbullimi i të dhënave, rezultateve të prodhimtarisë bujqësore	Qershor – Nëntor 2023	DBPZHR - Zyrtari dhe stafi	DPBZHR, MBPZHR dhe fermerët	Kryetari
12	Kontaktet dhe vizitat në fermat prodhuese - Mbi 20 vizita te fermat dhe individët	Shkurt - Qershor	DBPZHR dhe stafi	DPBZHR, MBPZHR dhe fermerët	
13	Përcjellja e programeve zhvillimore: - Memorandumi MBPZHR- K. Deçan për ndërtimin e tri kanaleve te ujitjes - Përzgjedhja dhe kalimi ne fazat e tenderimit te 3 kanaleve te ujitjes	Mars- Qershor	MBPZHR- Komuna, DBPZHR Komuna e Deçanit- Zyra e prokurimit	MBPZHR- K. Deçanit Komuna	
15	Trajnime në Menaxhimin e Integruar	Një trajnim	DBPZHR - QIKB	DBPZHR, MBPZHR	
16	Aktivitetet në Qendrën Informative Komunale të Bujqësisë - 121 konsulta dhe këshilla për fermer - 12 vizita në teren-pemëtore - 11 vizita në stalla - 4 vizita në sera	Janar - Qershor	QIKB-këshilltari	QIK DSHK Këshilltari publik i Shërbimeve Këshilluese te Kosovës	Kryetari MBPZHR

17	Organizimi i stafit për Pagesat Direkte: - Janë dixhitalizuar dhe është bërë Aplikimi për pagesat Direkte për 895 fermer	Prill-Qershor	DBPZHR dhe stafi	DBPZHR dhe MBPZHR	MBPZHR
18	Ndihma për fermerët aplikues në Grante	Janar - Qershor	DBPZHR,QIKB		
19.	Organizimi i Panairit te prodhimeve bujqësore	16-17 Qershor	DBPZHR dhe stafi	DBPZHR, MBPZHR dhe Ministrinë të tjera, OQ dhe OJQ	Kryetari
20.	Menaxhimi i projektit te Mëshqerrave: - Nënshkrimi i Marrëveshjes për Projektin e Mëshqerrave në mes Komunës dhe OJQ “Mëshqerra” - Komisioni komunal për zgjedhjen e përfituesve te 22 krerë lopë qumështore.	Shkurt - Qershor 07/02/2023	Donatori, Kryetari - DBPZHR	DBPZHR dhe Donatorët	Kryetari
21.	Është përpiluar Raporti për mbjelljet dhe realizimin e mbjelljeve pranverore si dhe planifikimi për korrje - shirje 2023	Maj - Qershor 2023	DBPZHR	DBPZHR dhe MBPZHR	
22.	Mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale	Tërë vitin	Rojet e pyjeve	DBPZHR,PK,MBPZHR	

23.	Damkosja e trungjeve në pyjet private dhe shtetërorë	Tërë vitin	Rojet e pyjeve		
24.	Bashkëpunimi me OJQ “Mëshqerra” Prishtinë - Negociatat për marrjen edhe të një kontingjenti të mëshqerrave (i treti me radhë) nga Irlanda për fermerët deçanas	Qershor-Shtator	Mëshqerra – Komuna, DBPZHR	Komuna dhe blegtorët	Kryetari

➤ Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike

Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike e konsideron publikimin dhe raportimin më shumë se përmbushje të një detyrimi ligjor dhe institucional.

Në vazhdim do t’ju paraqesim planifikimin 6 mujor të Drejtorisë për M.SH.SH.P, i cili është një konsiderim real i punës sonë gjatë periudhës Janar-Qershor plot angazhime dhe bashkëveprim në mënyrë profesionale.

Raporti 6 mujor i punës do të bartë në vete të gjitha punët e kryera në formë tabelare gjatë 6 mujorit të parë në mënyrë kronologjike ashtu si kanë qenë të planifikuara në planin vjetor të vitit 2023

1. SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

Aktivitetet e parapara sipas planit vjetor të Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike konkretisht Sektorit për Shërbime Publike dhe Sektorit për Mbrojtje dhe Shpëtim për 6 mujorin e parë të vitit, projektet që kanë vazhduar të mbikëqyren nga viti i kaluar si dhe projektet të reja të planifikuara për vitin 2023.

Nr.	Aktivitetet e planifikuara	Aktivitetet e realizuara/Vërejtje
1.	Ndërtimi, rekonstruimi dhe mirëmbajtja kapitale e rrugëve verore dhe dimërore	Vazhdon realizimi i kontratës
2.	Mbikëqyrja dhe menaxhimi i kontratës	Vazhdon realizimi i kontratës

	“Në Shtëpi”	
3.	Plani për menaxhimin e mbeturinave	I realizuar
4.	Mirëmbajtja e hapësirave publike, larja dhe fshirja e rrugëve, mirëmbajtja e lapidareve dhe memorialëve dhe varrezave të dëshmorëve, dekorimi i qytetit për festa zyrtare etj.	Vazhdon realizimi i të gjitha këtyre aktiviteteve
5.	Pilot projekti për kompostim për qytetin e Deçanit dhe fshatra	I përfunduar
6.	Mirëmbajtja e kanalizimit	Vazhdon
7.	Zgjerimi i ndriçimit Publik Efiçient	Projekt në realizim e sipër
8.	Mirëmbajtja e ndriçimit publik	Vazhdon
9.	Ndërtimi dhe asfaltimi Loti III- rrugët lokale dhe dytësore në fshatra	Projekt në vazhdim
10.	Ndërtimi, asfaltimi i R- 107	Projekt në vazhdim
11.	Ujësjiellësi në Bjeshkën e Madhe dhe bjeshkët tjera	Projekt në vazhdim
12.	Ndërtimi i Fshatit Turistik Podi i Gështenjave	Faza II /vazhdim
13.	Kanalizimi në zona urbane - impiante (Dranoc)	Vazhdon
14.	Elektrifikimi i bjeshkëve të Belegut	Projekti në vazhdim
15.	Ndërtimi i Shtëpisë Alpine Bjeshkatারে	Projekti në vazhdim

16.	Ndërtimi i objektit kulturor Qendra Rinore - Deçan	Projekt në vazhdim
17.	Ndërtimi i rrethojave dhe rregullimi i hapësirave brenda në oborret e Qendrës Rinore, Higjienës, Kolonisë së Artistëve, dhe Shtëpisë Alpine.	Vazhdon
18.	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në Pleqe	Projekt në vazhdim
19.	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në Deçan, Carrabreg, Beleg, Kodrali, Irzniq.	Projekt në vazhdim
20.	Ndërtimi i objektit të Kolonisë së Artistëve	Projekt në vazhdim
21.	Renovimi i objektit të Zjarrfikësve	Vazhdon
22.	Memoriali i Dëshmorëve në Bjeshkën e Belegut	Projekt në 6 mujorin e dytë
23.	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve për në Bjeshkën e Madhe	Projekt në 6 mujorin e dytë
24.	Ndërtimi i trotuareve në shkollat: Rastavicë, Ratishë dhe Kodrali	vazhdon
25.	Ndërtimi i objektit për mbeturina të vëllimshme	Projekt në pritje
26.	Ndërtimi i deponisë për mbeturina inerte	Projekt në pritje
27.	Shpërndarja e Komposterëve	Projekt në vazhdim
28.	Shtrirja e rrjetit të ujësjellësit në Belle	Projekt i realizuar
29.	Rekonstruimi i rrugëve të Bjeshkëve	Vazhdon

30.	Rruga Garda e Dukagjinit Kodrali	Projekt në vazhdim
31.	Asfaltimi dhe rregullimi i infrastrukturës së çerdhes në Deçan	Projekt në përfundim
32.	Asfaltimi i rrugëve në Belle	Projekt në vazhdim
33.	Eliminimi i deponive ilegale	Vazhdon
34.	Kryerja e punëve tjera administrative dhe punët tjera të pa planifikuara si takime me donator, vizita, trajnime etj	Gjatë vitit
35.	Dalje në terren në bazë të kërkesave të qytetarëve, identifikimi i deponive ilegale etj	Gjatë vitit
36.	Përcjellja dhe monitorimi i të gjitha kontratave që janë në kuadër të Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike nga zyrtarët e drejtorisë.	Gjatë gjithë vitit
37.	Dhënia e pëlqimeve për ndërprerjen e rrugës njëanësore, vazhdimi i lejeve për ushtrimin e veprimtarisë të taksive si dhe rregullimi e përcaktimi i orareve për operatorët e transportit publik, lëshimi i lejeve për vendosjen e pengesave rrugore etj.	Aktivitetet këto që janë kryer gjatë 6 muajve të parë të vitit 2023 si dhe aktivitete që vazhdojnë gjatë gjithë vitit.

1. SEKTORI PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Nr.	Aktivitetet e planifikuara	Aktivitetet e realizuara/ Vërejtje
1.	Azhurimi i planit për vlerësimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera	Në proces
2.	Mirëmbajtja e kamerave të qytetit dhe institucioneve publike në territorin e Komunës së Deçanit	I realizuar
3.	Raporti i vërsimeve të ndodhura në muajin Nëntor 2022 dhe në muajin Janar 2023	I realizuar dhe i dërguar ne AME-Prishtinë
4.	Servisimi dhe blerja e aparateve për mbrojtje nga zjarri për institucionet publike dhe lokale	Projekt i paraparë të filloj nga 6 maji i dytë
5.	Njoftimi për parandalimin e zjarreve	E realizuar
6.	Dalja në teren për vlerësimin e rrezeve të mundshme si: nga rryma, shtëpitë e pa banuara (të rrënuara) etj. Përpilimi i raporteve dhe dhënia e rekomandimeve çdo muaj	Çdo muaj
7.	Azhurimi në INTRANET i kërkesave të qytetarëve dhe organizatave të ndryshme të cilat adresohen në DMMSHP.	Çdo muaj
8.	Raporte, procesverbale dhe pëlqime për parandalim nga zjarri	Çdo muaj

9.	Numri i përgjithshëm i intervenimeve teknike dhe shërbime të zjarrfikësve për 6 mujorin e parë. (55 intervenime)	Çdo ditë
----	---	----------

➤ Drejtoria për Inspektion

Drejtoria për Inspekcione e Komunës së Deçanit, gjegjësisht inspektorët e kësaj Drejtorie, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit kalendarik 2023 kanë kryer punët dhe detyrat e punës mbështetur në Ligjet dhe aktet nënligjorë si dhe rregulloreve komunale me të cilat rregullohet puna e inspektorëve sipas fushave përkatëse, duke ju përmbajtur Planit të punës së Drejtorisë për vitin 2023.

Në Kuadër të Drejtorisë gjatë këtij gjashtëmujori kanë qenë të sistemuar Inspektori i Tregut, Inspektori i Mbrojtjes së Ambientit, Inspektori i Ndërtimit (me kontratë mbi shërbimet e veçanta), Inspektori i Veterinës (i angazhuar me kontratë mbi shërbimet e veçanta) dhe Inspektori i Bujqësisë që njëkohësisht është edhe shef i inspektorëve.

Secili nga Inspektorët ka vepruar sipas detyrës zyrtare, sipas kërkesave dhe ankesave të palëve dhe sipas kërkesave të organeve tjera kompetente.

Në mënyrë permanente është bërë mbikëqyrja inspektuese e subjekteve tregtare dhe hoteliere me theks të veçantë lidhur me respektimin e orarit të punës, vendosjen e çmimeve të mallrave për tregtim, afati i skadimit të produkteve ushqimore, ndërtimet pa leje apo në kundërshtim me lejen ndërtimore të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit. Në mënyrë permanente është bërë kontrolli i therjes së kafshëve në thertoret e licencuara.

Sipas kërkesave të operatorëve ekonomik është bërë pranimi i lokaleve të subjekteve sa i përket kushteve minimale higjienike teknike dhe te mbrojtjes në punë.

Janë bërë kontrole sipas kërkesës së Policisë së Kosovës (me të cilët ekziston një bashkëpunim mjaft i mirë), posaçërisht për mallrat e hasura në transportin rrugor pa dokumente përkatëse përcjellëse, mosrespektimin e orarit të punës sidomos nga subjektet hoteliere, por edhe sipas denoncimit të palëve në polici për pa rregullsitë e hasura te subjektet tregtare, sidomos nga lëmi i çmimeve dhe afati i skadimit të artikujve ushqimor.

Janë kryer edhe punë tjera sipas fushë veprimtarisë të secilit nga inspektorët.

Në tabelën në vijim po e prezantojmë aktivitetin e inspektorëve:

Inspektori	Kontroll inspektuese në terren sipas detyrës zyrtare	Kontroll inspektuese në terren sipas kërkesës së personave fizik dhe juridik	Procesverbale të hartuara për konstatimin e gjendjes	Aktvendime	Kërkesa për gjykatat kompetente
I Tregut	17	22	45	5	2
I Ndërtimit	14	4	9	1	/
I Mbrojtjes së Ambientit					
I Veterinës	42	13	13	/	/
I Bujqësisë	5	6	6	/	/
Gjithsej:	78	45	73	6	2

Kërkesë: Si çështje e ndjeshme që është lëmia e ndërtimit, zgjidhja e çështjes së Inspektorit të ndërtimit.

➤ Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim gjatë kësaj gjatësie mujori të parë të vitit 2023, ka realizuar këto aktivitete:

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim gjatë gjatësie mujorit të parë të vitit 2023, në kuadër të fushë veprimtarisë ka ofruar këto punë/shërbime zyrtare të bazuar në Statutin e Komunës, në harmoni me ligjet e Kuvendit të Kosovës, aktet tjera nënligjore, Rregulloret e miratuara nga Kuvendi Komunal i Deçanit, dokumenteve strategjike dhe planin e punës për vitin 2023. Punët/shërbimet e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik fokus të veçantë i është kushtuar hartimit dhe realizimit të politikave zhvillimore, marrja e masave sa më të përshtatshme për të nxituar më tutje zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Komunës së Deçanit, krijimin e kushteve sa më të favorshme, infrastrukturës dhe mjedisit sa më të

përshtatshëm për zhvillim të ndërmarrjeve të vogla, mesme, për një zhvillim sa më të qëndrueshëm. Fokus të veçantë vazhdon t'i kushtohet promovimit të zhvillimit ekonomik, turizmit, zbutjes së papunësisë, duke mundësuar gjenerimin e vendeve të reja të punës. Pra, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik vazhdon me intensifikimin e angazhimeve të saj drejt përmirësimit të klimës së të bërit biznes, promovimin e Komunës së Deçanit si një komunë atraktive, për investitorët strategjik për të investuar dhe për tu vizituar, gjithmonë e hapur ndaj ideve inovative dhe projekteve të reja smart, gjithmonë duke ofruar shërbime/konsulenca profesionale.

1. Harton politikat e zhvillimit ekonomik për komunën;
2. Bashkëpunon me organet e tjera komunale me qëllim të informimit për plane zhvillimore;
3. Bënë analiza që shërbejnë si bazë për planet zhvillimore;
4. Cakton dhe propozon prioritetet e zhvillimit në fusha të ndryshme e sidomos në fushën e Turizmit;
5. Organizon ekipe të ekspertëve të ndryshëm për banim të planit të zhvillimit ekonomik në nivel komune dhe hartimin e projekteve kapitale për përfitimin e donacioneve;
6. Harton strategjinë e zhvillimit të përgjithshëm afatmesëm dhe afatgjatë për komunën;
7. Bashkëpunon me organet relevante në nivelin lokal dhe atë qendror;
8. Bashkëpunon me ekspertë të fushave të ndryshme që ofrojnë përvoja të ndryshme në zhvillim;
9. Jep këshilla me interes për ekonominë private-reale;
10. Merr pjesë në seminare-promovime të karakterit zhvillimor;
11. Kryen edhe punët tjera në fushën e zhvillimit ekonomik.

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtori:

- Regjistrimi i bizneseve fillestare (të gjitha bizneset individuale B.I, shoqëritë aksionare, ortakëri e përgjithshme, ortakëri e kufizuar, shoqëria e huaj), tregtare, ndërmarrjet shoqërore dhe kooperativat bujqësore;
- Regjistrimi i ndryshimeve në biznes;
- Pajisje me certifikata të reja me Numër Unifikues;
- Pajisja me informata shtesë për biznes;
- Protokollimi i të gjitha lëndëve që kanë të bëjnë me biznes;
- Raportet javore dhe mujore pranë MTI;
- Vërtetime për persona fizik që nuk ushtrojnë veprimtari biznesore;
- Vërtetime që nuk posedojnë obligime të taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste biznesore;
- Shqyrtimi i lëndëve: kërkesave, ankesave dhe të ngjashme;
- Ngarkesa e taksës komunale për biznese;
- Konsulenca me palët/bizneset si dhe

- Punë dhe angazhime tjera në komisione.

Sipas zyrës për biznese, numri i bizneseve të regjistruara nga data 01.01.2023 deri me datën 30.06.2023 janë të regjistruara **38** biznese të reja, të cilat biznesenë bazë të deklarimeve të tyre punësojnë **71** punëtorë. Bizneset fillestare brenda ditës pajisen me çertifikatën e biznesit me Numër Unifikues të biznesit, si dhe jepen konsulenca të ndryshme të kësaj natyre për ta krijuar një ambient sa më të volitshëm për regjistrim dhe të gjitha ndryshimet e nevojshme në biznes. Shikuar në bazë të kësaj periudhe ky numër i bizneseve të regjistruara duket si vijon:

Lloji i Pronësisë	Numri i Bizneseve
Biznes individual	10
Ortakëri e përgjithshme	/
Ortakëri e kufizuar	/
Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	27
Shoqëri Aksionare	/
Ndërmarrje në pronësi të huaj	1
Ndërmarrje publike	/
Kooperativë bujqësore	/
TOTALI:	38

- **Ndryshimet në Biznes / Informata Biznese**

Nr.	Shërbimi/Lënda	Totali
-----	----------------	--------

1.	Shuarje të bizneseve	15
2.	Kërkesë për shtimin apo heqjen e aktivitetit	23
3.	Kërkesë për informata	51
4.	Kërkesë për shtim apo ndryshim të njësisë	4
5.	Kërkesë për ndryshim të adresës	6
6.	Kërkesë për ndryshimin e drejtorit apo përfaqësuesit të autorizuar	3
7.	Kërkesë për çertifikatë dublikat	3
8.	Kërkesë për ndryshim të emrit tregtarë	/
9.	Kërkesë për ndryshim të kapitalit	/
10.	Kërkesë për ndryshimin e pronarëve/aksionarëve	16
11.	Çertifikata të reja për biznese fillestare	38
12.	Çertifikata të ripërtërira me numër Unik	78
13.	Vërtetime për persona fizik që nuk ushtrojnë veprimtari biznesore	22
14.	Vërtetime për persona fizik që nuk ushtrojnë veprimtari biznesore	15

➤ Aktivitetet e Drejtorisë

- U realizuan takime me përfaqësuesit e institucioneve të nivelit qendror, organizatave vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të arritjes së marrëveshjes/bashkëpunimit për të gjetur mundësinë e përkrahjes/financimit të projekteve zhvillimore, të cilat do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik të Komunës së Deçanit dhe sektorit privat/bizneseve të cilat operojnë në territorin e Komunës së Deçanit;
- Janë realizuar takime me përfaqësuesit e bizneseve ku janë diskutuar për sfidat, pengesat, mundësitë dhe planet zhvillimore;

- Vizitë Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim në Komunën e Gjakovës, Pejës dhe Junikut, qëllimi i vizitës ishte krijimi i bashkëpunimit midis drejtorive komunale;
- Takim me kryetarin e Ulqinit në lidhje me evenimentet që do të organizohen në Komunën e Deçanit;
- Pjesëmarrje në hapjen e Sezonit Turistik në Lezhë;
- Vizitë në disa biznese në Durrës me qëllim të promovimit të Panairit Veror që mbahet në Komunën e Deçanit;
- Janë realizuar takime me përfaqësuesit e shoqatave dhe organizatave joqeveritare, me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në nivelin lokal të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e jetës ekonomike, sociale;
- Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim ka vizituar bizneset prodhuese për t'u njoftuar nga afër me problemet, sfidat dhe mundësitë e ndihmës nga pushteti lokal;
- Pjesëmarrës në organizimin e Panairit të Lezhës në Prishtinë;
- Thirrje për aplikim për subvencionim me mjete financiare për NMVM lansuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA);
- Raportimi i Planit të Veprimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2021-Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Takim me përfaqësues të Agjencisë Italiane si dhe përfaqësues nga organizata Celim në lidhje me projektin NaturKosova si dhe fazat e tjera të projektit në vazhdimësi të tij.
- Thirrja për Propozime të Programit për Zhvillim Rajonal - Investime Kapitale-Zyrat e Agjencisë për Zhvillim Rajonal;
- Krijimi i grupit të anëtarëve në Grupet Punuese Rajonale në lidhje me promovimin e Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore në AZHR Perëndim;
- Pjesëmarrës në punëtorinë me temën "Bashkëpunimi Ndërkomunal" -Instituti Kosovar për Qeveri Lokale;
- Organizmi i takimit dhe pritja e musafireve të Odës së Artizanatit të Rajonit Shtutgartit (HWK) dhe shoqatës GHA(German Health Alliance);
- Draft Strategjia e Turizmit-Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Krijimi i listës me Shtëpitë akomoduese në Bjeshkët e Nemuna-Përmes Organizatës së Swisscontact në Kosovë;
- Pjesëmarrje në punëtorinë: "Komunat e Mençura dhe Promovimi i tyre"-Asociacioni i Komunave të Kosovës;
- Krijimi i 4 shtigjeve të çiklizmit në zonën e Komunës së Deçanit;
- Pjesëmarrës në organizimin e CHwB Kosova në lansimin e publikimit **“Shijet e Dukagjinit”**;
- Takim me përfaqësues nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, zyrtar i lartë, z. Arain Krasniqi me të cilin diskutuam për atraksionet turistikë të Komunës së Deçanit;
- Bashkëpunimi në mes AZHR-Perëndim dhe projektit PPSE (shqip: Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat) të organizatës “Swiss Contact”;
- Pjesëmarrës në dëgjimin publik lidhur me Projektligjin për turizmin- Komisioni Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti;
- Krijimi i listës së të gjitha Hoteleve/Restauranteve dhe Resorteve nga Deçani që mund të jenë target grup i projektit tonë, si dhe po ashtu edhe statistika të përditesuara për sektorin e Turizmit, Hotelierisë etj., sikurse edhe arritjet/sfidat/nevojat për Sustainable Tourism Management, Prishtina REA;
- Thirrja për propozime: Skema e Garantëve “Programi për Zhvillimi Rajonal të Balancuar“ PZHRB 2023, Start-up dhe Biznes ekzistues Lot I dhe Lot II;

- Bashkëpunimi me përfaqësues nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Sektori i turizmit në lidhje me promovimin e turizmit të Komunës së Deçanit;
- Pjesëmarrës në Konferencën e Donatorëve 2023, si dhe propozimi për projektet adekuate nga Komuna e Deçanit;
- Pjesëmarrës në punëtorinë me temën “Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030”, organizuar nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale;
- Takim me përfaqësues nga Jakova Innovation Center - Projekti "Të bashkuar drejt fuqizimit të të rinjve, grave dhe grupeve të pafavorizuara";
- Takim me Swisscontat –Diskutimi i temave në lidhje me projektet e turizmit në Komunën e Deçanit;
- Takimi me përfaqësues nga “Unhz” - Tema në lidhje me turizmin dhe objektet turistike në Komunën e Deçanit;
- Pjesëmarrës në Panairin e organizuar nga IAAP "Tafil Kasumaj" në Deçan 2023;
- Vizitë në disa biznese të Komunës së Deçanit me qëllim njoftimi nga afër për problemet, vështësitë, sfidat që po kalojnë si biznese (gjatë muajit qershor);
- Vizitë në disa biznese Prodhuese të Komunës së Deçanit- (bizneset që eksportojnë produkte jashtë Kosovës);
- Pjesëmarrës në eventin e themelimit të Shoqatës së Miqësisë Kosovë-Austri, si dhe diskutimi në lidhje me temat e përbashkëta që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik të Komunës së Deçanit;
- Pjesëmarrje në Trajnimin: "Komunat Gjithëpërfshirëse-Asociacioni i Komunave të Kosovës;
- Pjesëmarrës në Punëtorinë - Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm dhe rajonal përmes projekteve për investime kapitale, organizuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe në partneritet me UN-Habitat Kosovë;
- Aplikimin në Fondet Europiane IPA në thirrjen Kosovë – Shqipëri;
- Pjesëmarrës në trajnimet e CNASAS në zonën e Bjeshkëve të Nemuna – Komuna e Deçanit përfaqësuar nga Zyra e Turizmit dhe 6 anëtarë të tjerë;
- Pjesëmarrje në Takimin me Kolegjiun për Zhvillim Ekonomik Lokal - z. Sazan Ibrahim – Drejtor Ekzekutiv i AKK-së;
- Pjesëmarrje në trajnimin me temën “Pjesëmarrja e Komunave në programet IPA”-Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale;
- Pjesëmarrës në Tryezë:BASHKËPUNIMI DHE KOORDINIMI NË FUSHËN E TURIZMIT-Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Pjesëmarrës në Programin IPA, Bashkëpunimi Ndërkufitar Shqipëri-Kosovë 2014-2020 (Rahovec), Departamenti i Investimeve në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Takimi me përfaqësues nga Departamenti i Investimeve në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Krijimi i grupit punues dhe fillimi për përpilimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Deçanit;
- Takim i Kolegjiut për Zhvillim Ekonomik Lokal –Maj 2023;
- Krijimi i ekipit dhe projektimi i Projektit për ZipLine – Deçan;
- Pjesëmarrës në punëtorinë /Harmonizimi i Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal me agjendat për zhvillim të qëndrueshëm/Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, GIZ,dhe IKAP;
- Organizmi i nënshkrimit të memorandumit për Brendin Rajonal të Trashëgimisë Kulturore nga CHwB dhe 6 komunat rajonale;
- Pjesëmarrës në Punëtorinë me temën "Sfidat e implementimit të legjislacionit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale”- Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale;
- Takim i Kolegjiut për Zhvillim Ekonomik Lokal-Asociacioni i Komunave të Kosovës;

➤ Zhvillimi dhe promovimi i turizmit

Në këtë vit është punuar në promovimin dhe zhvillimin e Turizmit dhe janë mbajtur aktivitete të ndryshme:

- Përgatitja dhe shpërndarja e Fletushkave të bjeshkëve;
- Shtigjet e shënjestuara për ecje/hiking në Bjeshkën e Roshkodolit, Bjeshkën e Prilepit, Bjeshkën e Belegut, Zallin e Rupës, Bjeshkën e Deçanit dhe Carrabregut deri tek Maja e Gjeravicës;
- Promovimi i bukurive natyrore dhe burimeve turistike në zonat rurale dhe malore në këto bjeshkë dhe komunën e Deçanit përmes tri (3) video klipëve;
- Rregullimi i hapësirave të Qendrës Informuese Turistike;
- Lansimi i web-faqes së turizmit të Deçanit <http://decanitourism.org>;
- Programi ndërkuftar Kosovë dhe Mali i Zi;
- Seminari mbi Turizmin e Përgjegjshëm të organizuar nga Volontari nel Mondo-RTM në kuadër të projektit NaturKosovo;
- Kordonimi me Qendra të Informimit dhe OJQ të ndryshme për bashkëpunime në Turizmin;
- Bashkëpunimi me SWISS CONTACT; USAID; CDF; ADF; ECO; Bashkimi Evropian; GIZI;
- Krijimi i Ekipit të Kërkim - Shpëtimit nga Komuna e Deçanit;
- Vendosja në hartë e shtigjeve të çiklizmit urban të qytetit të Deçanit;
- Aktiviteti “Ngjitja në Bellen e Balajve”;
- Aktiviteti “Ngjitja në Bjeshkën e Madhe”;
- Ngjitja në Via Ferrata në Ditën e Çlirimit të Deçanit, aksion për promovimin e Via Ferrata;
- Koncert i madh në qendër të qytetit në ditën e dytë përmbyllëse të Panairit Veror;
- Panairi Tradicional Veror i organizuar me 45 biznese dhe kompani nga qytetet e Kosovës si dhe shtetet e tjera fqinje si, Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia;
- Koncert i madh me artistë dhe emra të njohur nga Estrada e Kosovës në përkrahje të bokserit Robin Haxhi Krasniqi;
- Trajnimi për rrjete sociale nga NaturKosova;
- Pjesëmarrja në Itali në kuadër të NaturKosovo (Vizitë Studimore 5 ditë në Regjionin e Bolognes dhe pjesëmarrës në dhjetëra takime me përfaqësues dhe aktet e turizmit Italian);
- Pjesëmarrja në shenjëzimin e shtigjeve në bjeshkët e Deçanit;
- Pastrimi dhe shenjëzimi i shtegut të hekurt Via Ferrata;
- Fizibiliteti i shtigjeve dhe zgjerimi i tyre përgjatë shtegut Via Dinarica;
- Pjesëmarrja në trajnimin e Kërkim Shpëtimit Malor;
- Organizmi i takimit për Projektin NaturKosovo në prezantimin e Grandeve si dhe mundësia e kyqjes së bizneseve, fermerëve dhe shoqatave që merren me turizëm në Komunën e Deçanit;
- Organizmi i trajnimeve për aplikimin në Grandet e Projektit NaturKosovo;
- Takim me përfaqësues nga Shoqata e Kayakit – Deçani (organizmi i aktivitetit në muajin gusht me Kayak në Liqenin e Radoniqit);
- Aktiviteti me Utalaya - Trajnimi: Digital Marketing gjatë dy ditëve me pjesëmarrës për të gjithë të interesuarit e Komunës së Deçanit;
- Bashkëpunimi dhe vizita të ndërlidhura me Bashkinë e Lezhës dhe Ulqinit;

- Bashkëpunim dhe vizitë në qytetin e Tetovës në lidhje me promovimin e turizmit;
- Emisione të ndryshme në TV, me karakter të promovimit të Turizmit;
- Aktiviteti me Uralaya- Prezantimi nëpër Shkollë - Informative and awareness-raising initiatives on biodiversity and natural heritage of VD (si dhe përshkrimi i shtegut nga Ura e Demes deri te Qendra Informuese Turistike – Visit Deçani);
- Pjesëmarrës në Panairin e Turizmit dhe Sportit në Prishtinë 27-28 Prill 2023;
- Takim me përfaqësues nga Agjencia Italiane e Turizmit në Junik në lidhje me projektin NaturKosovo (shkurt 2023);
- Pjesëmarrës në organizmin e Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale - NJË DEKADË E GJYSMË NGA DECENTRALIZIMI;
- Organizmi i takimit me Organizatën “Celim” nga Italia në lidhje me fazën e projekteve në vazhdimësi të NaturKosovo;
- Pjesëmarrës në takimin e organizuar nga CHwB në promovimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes për Brendin Rajonal të Trashëgimisë Kulturore;
- Pjesëmarrës në organizmin e Institutit Kombëtar Demokratik (NDI), me mbështetje nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) për organizim e edicionit të dhjetë të Javës së Gruas në Kosovë;
- Raportimi për Zbatimin e planit të veprimit të SZHEK (raporti vjetor);
- Vizitë në fshatin Turistik Belle, qëllimi i vizitës - Promovimi i turizmit;
- Vizitë në fshatin Turistik Pleqe me anë të cilës pretendojmë promovimin e turizmit;
- Bashkëpunimi dhe zhvillimi i projektit me OJQ “Shkelzen Haradinaj” – “Touris hubs for better offer in less advantaged mountainous areas”;
- Bashkëpunim me OJQ “Kosovo Mountain Club” në lidhje me turizmin dhe projektet që kanë të bëjnë me zhvillimin e turizmit në Komunën e Deçanit;

➤ Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër

1. Shefi i Shërbimit njëkohësisht edhe zyrtari për RDPP së bashku me referentën e ndryshimeve kadastrale

Gjatë periudhës për të cilën po raportojmë, përkatësisht prej fillimit të vitit 2023 e deri me datën e përpilimit të këtij raporti, Zyrtari për RDPP ka pranuar gjithsej **260** kërkesa nga palë të ndryshme për realizimin e të drejtave ligjore që dalin nga Regjistrimi i të Drejtave në Pronën e Paluajtshme (RDPP).

Nga të gjitha këto kërkesa deri më tani janë shqyrtuar **256** dhe për të njëjtat janë lëshuar aktvendime adekuate me të cilat palëve i'u është njohtë e drejta ligjore e kërkuar ose ju ka refuzuar e njëjta kërkesë dhe ju ka dhënë e drejta e ankesës në organin e shkallës së dytë. Ndërsa **4** kërkesa janë në procedurë e sipër.

I njëjti ka lëshuar **405** aktvendime për azhurimin e lëndëve të terrenit.

Aktvendimet me të cilat palës i është njohtë e drejta në RDPP, në afat ligjor dërgohen te referenti për ndryshime kadastrale i cili konform këtyre vendimeve bënë azhurimin në librat përkatës të elaboratit kadastral dhe të njëjtat prapë i azhurnon duke i fut të dhënat në kompjuter, përkatësisht në programin e SIKTK.

Krahas këtyre punëve zyrtari për RDPP i cili i kryen edhe detyrat e shefit të shërbimit ka kryer edhe punë tjera nga lëmi i shërbimeve pronëso- juridike si dhe së bashku me referentin për ndryshime kadastrale kanë kryer edhe punë tjera me urdhër të drejtorit.

2. Zyrtarët e mirëmbajtjes së Kadastrit

Në këtë sektor punojnë tre zyrtar për mirëmbajtjen e Kadastrit.

Këta zyrtar gjatë periudhës raportuese kanë pasur **125** azhurime të lëndëve ngaterreni sipas kërkesës së palëve siç janë: ndarja e parcelave, bashkimi i parcelave, regjistrimi i objekteve, korrigjimi i sipërfaqeve, korrigjimi i mexhave dhe futja e të dhënave të reja në sistem etj. Këto lëndë të gjitha janë zgjedhur me përjashtim të **4** rasteve të cilat ende janë në procedurë e sipër. Pas azhurimit të këtyre lëndëve zyrtarë kanë lëshuar për secilin rast aktvendim përkatës.

Gjithashtu zyrtarët gjatë kësaj periudhe kanë lëshuar **2** historiate dhe identifikime të mexhave sipas kërkesave të palëve dhe kanë lëshuar **269** kopje plani.

Gjatë kësaj periudhe raportuese këta zyrtar kanë dal në teren për **2** raste nga domeni pronëso- juridik, e sipas kërkesës zyrtare të bërë nga ana e Komunës së Deçanit, për nevoja të komunës. Si dhe kanë kryer edhe detyra tjera sipas nevojave të cilat paraqiten në këtë shërbim siç janë konsultat me palë dhe punë tjera në zyrë.

3. Referenti për pranimin e palëve

Gjatë periudhës për të cilën raportojmë, referenti për pranimin e palëve ka pranuar gjithsej **1541** kërkesa të cilat kryesisht kanë të bëjnë me dhënien e çertifikatave të pronës së paluajtshme, kopjeve të planit dhe vërtetimeve me të cilat vërtetohet se a ka apo nuk ka pala pasuri të paluajtshme, në territorin e komunës.

I njëjti zyrtar i ka proceduar të gjitha këto kërkesa dhe për secilën kërkesë palët janë pajisur me dokumente përkatëse në afatin brenda ditës së paraqitjes së kërkesës. I njëjti punëtor krahas këtyre punëve ka kryer edhe punët e përpunuesit në SIKTK.

Për hir të thjeshtësimit të të dhënave për punët e kryera të këtyre punëtorëve këtij raporti po ia bashkëngjitem edhe formën tabelare të lëndëve të pranuar sipas muajve dhe llojit të kërkesave.

Lloji i lëndëve	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Totali
Aktvendimet për ndryshime Kadastrale:	048	048	045	039	048	032	0260
Azhurimi i lëndëve – terreni:	010	021	022	019	034	019	0125
Lëshimi i kopjeve të planit:	023	030	048	047	055	043	0246
Lëshimi i certifikatave dhe vërtetimeve:	219	294	303	215	298	212	1541
Totali për muaj:	300	393	418	320	435	306	2172

Sipas kësaj del se kjo Drejtori gjatë kësaj periudhe bazuar në kërkesat e palëve ka lëshuar gjithsej **2164** dokumente valide dhe në procedurë janë edhe **8** kërkesa.

Kjo drejtori krahas këtyre punëve të evidentuara më lartë ka kryer edhe punë tjera të parashtruara konform kërkesave të palëve private dhe organeve komunale.

➤ **Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport**

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport gjatë periudhës Janar – Qershor të vitit 2023, ka realizuar këto aktivitete:

- Promovimi i librit “Belleja Monografi”, nga autori Faton Mehmetaj, mbajtur me datë **03.02.2023**, në sallën e Kuvendit Komunal.
- Për nder të 15 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës janë mbajtur këto aktivitete:
- Me datë **15.02.2023** është mbajtur Akademi Përkujtimore me rastin e 80 vjetorit të vrasjes nga forcat serbe të At Lorenc Mazrekut, në sallën e Kuvendit Komunal.
- Aktivitet me karakter garues “Valle Popullore” të Traditës me nxënësit e shkollave fillore të Komunës së Deçanit, mbajtur me datë **16.02.2023**, në sallën e Kuvendit Komunal.
- Seancë Solemne për nder të 15 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, mbajtur me datë **17.02.2023**.
- Homazhe pranë varrezave të Dëshmorëve në Kompleksin Memorial “Dëshmorët e Kombit” në Gllogjan me datë **17.02.2023**.
- Përrurimi i Muzeut Etnologjik në Deçan me datë **17.02.2023**.
- Festivali Gjithëkombëtar i Lahutës, i mbajtur në Shaptej të Deçanit me datë **19.02.2023**.
- Seancën Solemne me datë **28.02.2023**, ku kemi ndarë mirënjohje të qytetit për Prof. Dr. Sylë Tahirsylaj, në shenjë mirënjohje dhe respekti për kontributin shumëvjeçar në shkencë, kulturë dhe çështje kombëtare.
- Turniri Tradicional i Shahut “Zeqë Hasaj”, mbajtur me datë **19.03.2023**, për nder të 25 vjetorit të Epopesë së Dukagjinit.
- Panairi i librit, i mbajtur me datë **21.03.2023**, në oborrin e komunës, ku po ashtu u bë promovimi i librit “Komiteti i Deçanit” të autorit Hasan Ukëhaxhaj dhe promovimi i librit “Fajtori” të autorit Besnik Mustafaj (në sallën e Kuvendit Komunal), në kuadër të aktiviteteve për nder të 24 Marsit “Epopesë së Dukagjinit”.
- Koncerti i parë klasik në Deçan, nga solistet e Fakultetit të Arteve “Haxhi Zeka” në Pejë, mbajtur me **21.02.2023** në Gjimnazin “Vëllezërit Frashëri” në Deçan.
- Kroso sportiv “Rruga e Lirisë” me nxënësit e shkollave fillore, mbajtur me **22.02.2023**, ku po ashtu bëmë hapjen e ekspozitës “Marsi Lirisë”, me punime të nxënësve kushtuar Epopesë së Dukagjinit.
- Manifestimi Qendror në shënim të 25-vjetorit të Epopesë së Dukagjinit, me **24.03.2023**, në Gllogjan.
- Turniri Ndërkombëtar i Boksit, në kuadër të aktiviteteve për nder të 24 Marsit “Epopeja e Dukagjinit”, ku morën pjesë boksier nga Shqipëria, Maqedonia, Italia, Zvicra dhe të gjitha klubet e boksit të Kosovës, me datë **25.03.2023**.
- “Marshi i Lirisë” në nderim të luftëtarëve të UÇK-së, Shkëlzen Haradinaj, Fatmir Nimanaj, Hasim Halilaj dhe Luan Nimanaj me datë **16.04.2023**.
- Manifestimi Tradicional “Zëri i Vëllazërisë 2023”, me moton “Respekt njerëzve të sakrificave sublime për atdheun”, i organizuar nga Shoqata “Martin Dreshaj” në bashkëpunim me Komunën e Deçanit, me datë **29.04.2023**, në sallën e Kuvendit Komunal.
- Dita e Dëshmorëve të Deçanit, me **05.05.2023**.
- Turniri Tradicional në Futsall “Luan Haradinaj” me **06.05.2023**, në sallën e sporteve në Isniq.
- Atraksioni “Via Ferrata”, për nder të “Ditës së Çlirimit”, me datë **15.06.2023**.
- Festivali Gjithëkombëtar i Folklorit “Eshkë e Ndezur mbi Shkëlzen”, me **15.06.2023**.

- Dita e Çlirimit të Deçanit, **16.06.2023**.
- Nata finale e Festivalit Gjithëkombëtar të Folklorit “Eshkë e Ndezur mbi Shkëlzen”, me **16.06.2023**.
- Koncert për nder të “Ditës së Çlirimit” me **17.06.2023**.
- Manifestimi në mbështetje të Kampionit të boksit – Haxhi Krasniqi, me datë **26.06.2023**.

Gjatë këtyre gjashtë muajve të vitit 2023, Ansambli i Këngëve dhe Valleve “Deçani” ka përfaqësuar me shumë sukses shtetin e Kosovës në Çeki, po ashtu ansambli ka treguar shumë suksese gjatë vitit 2023, me shumë pjesëmarrje nëpër festivale, me fitore të shumë çmimeve kryesore.

Gjithashtu edhe në sport është arritur sukses shumë i madh gjatë këtyre muajve, si në fitore, po ashtu edhe në sponzorizim të klubeve sportive.

Raporti i punës Janar – Qershor në Arkivin Komunal të Deçanit

Arkivi Komunal në Deçan, funksionin e vet të punës e kryen në harmoni dhe në përputhje me dispozitat ligjore, në harmoni me rregulloret e pushtetit qendror dhe atë të pushtetit lokal.

Ne si punëtor të këtij sektori jemi angazhuar që të bëjmë klasifikimin dhe sistemimin e lëndëve arkivore.

Për periudhën Janar - Qershor, në Arkivin Komunal të Deçanit janë kryer punë dhe detyra të caktuara sipas programit të punës, në mënyrë që sa më mirë të bëhet ruajtja e dokumentacionit arkivor.

Në kuadër të qeverisjes janë të ndërtuara disa aplikacione për administratë elektronike siç është SMAED, E-Arkivi dhe Intraneti.

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur palë, të cilat kanë kërkuar lëndë të ndryshme për shfrytëzim. Lëndët e kërkuara kanë qenë: raporte të LAL Kurorave, Aktgjykime, Aktvendime, Vendime të ndryshme.

Lënda pranohe në Arkivin e Komunës kryesisht e pa rregulluar, por vetëm e regjistruar nga Zyrtarët e Arkivit të Komunës – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

DREJTORIA E ADMINISTRATËS:

1. Lëndët e Ali Aliçkaj - Ofiqar i Gjendjes Civile.

Nr.	Emri i Lëndës	Nr. i Lëndëve	Nr. i Follderave
1	Aktgjykime	22	1
2	Aktvendime	19	1
3	Vendbanim	13	1
4	Lal	100	3
5	Lam	97	4
6	Lav	15	3
7	Bota e Jashtme	24	1
2. 8	Lirim nga Shtetësia	42	1
	Gjithsej	332	15

2. Lëndët: Aktvendimet e Hate Shehu - Shefe e Administratës

Nr.	Emri i Lëndës	Nr. i Lëndëve	Nr. i Follderave
1	Aktvendime	252	8
2	Lirim nga Shtetësia	80	2



3	Fitim i Shtetësisë	32	2
	Gjithsej	364	12

3. Lëndët e Xhavit Shala - Arkës

Nr.	Emri i Lëndës	Viti	Nr. i Follderave
1	Arka	2021-2022	60

4. Lëndët e Gjimnazit “Sami Frashëri” në Irzniq, tashmë e mbyllur që nga viti 2016, gjinden në Arkivin Komunal dhe i lëshon dokumentacionin e këtij gjimnazi.

Nr.	Emri i Lëndës	Numri
1	Diploma	8

5. Lëndët e vjetra të stazhit të punës:

Nr.	Emri i Lëndës	Numri
1	Palët kanë tërhequr dokument.	15

6. Përmes SMAED kemi arkivuar në mënyrë elektronike këto dosje:

Disa janë arkivuar, mirëpo për shkak të punimeve në program kanë mbet disa lëndë pa u arkivuar

7. Gjatë kësaj periudhe kemi pasur palë, të cilat kanë kërkuar lëndë të ndryshme për shfrytëzim. Lëndët e kërkuara kanë qenë: raporte të kurorave, aktgjykime, aktvendime të ndryshme, numri i të cilave arrin numrin:

Nr.	Lëndët	Nr. i Lëndëve
1	LAL, LAM. LAV	79